



SECRETARIAT FOR SECONDARY AND PRE-SECONDARY EDUCATION
SOCIETY OF JESUS
ROME

Shkollat e Jezuitëve NJË TRADITË E GJALLË NË SHEKULLIN XXI

Një ushtrim i vazhdueshëm shohitjeje

SHKOLLAT E JEZUITËVE: NJË TRADITË E GJALLË NË SHEKULLIN XXI

Një ushtrim i vazhdueshëm shohitjeje

Autori:

ICAJE

(The International Commission on the Apostolate on Jesuit Education)

Roma, Italia, settembre 2019 prima edizione in inglese

Edizione italiana a cura di Eraldo Cacchione SJ

Revisione della traduzione: Mario Danieli SJ

PERKTHIMI NGA ITALISHTJA: LORETA TOMAJ

REDAKTIMI: EMANUELA MATIJA

Të gjitha imazhet janë pronësi e Shoqërisë së Jezusit, të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Treguesi

- 9 Shkollat e Jezuitëve: një traditë e gjallë në shekullin XXI
- 11 Hyrje: bashkëbisedimi duhet të vazhdojë...
- 14 Anëtarët aktualë të ICAJE-s
- 15 Hyrje
- 17 • Një ushtrim në shoshitje
- 19 • Të rrënjosur në Ushtrimet Shpirtërore
- 21 Struktura e dokumentit
- 23 Pjesa e Parë: Dokumente bazë**
- 25 A) Karakteristikat e veprimitarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit (1986)
- 26 B) Pedagogjia Injacione: Hyrje në Praktikë (1993)
- 28 C) Preferencat Apostolike Universale të Shoqërisë së Jezusit (2019)
- 32 D) Dokumente të tjera të rëndësishme
- 33 Pjesa e Dytë: realiteti i ri i botës**
- 34 1. Realiteti socio-politik
- 45 2. Edukimi
- 49 3. Ndryshime në praktikën fetare
- 50 4. Ndryshime në Kishën katolike
- 52 5. Ndryshime në Shoqërinë e Jezusit
- 59 **Pjesa e Tretë: elemente identifikuese globale të shkollave të Jezuitëve**
- 61 Të vepohet si një trup universal me një mision universal
- 63 1) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara të jenë katolike dhe të ofrojnë një formim të thellë në fe dhe në dialog me besime fetare e vizione të tjera të botës
- 66 2) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë
- 67 3) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në qytetarinë globale
- 69 4) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në kujdesin ndaj krijimit
- 71 5) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në drejtësi
- 73 6) Shkollat e Jezuitëve angazhohen që të jenë të arritshme prej të gjithëve
- 75 7) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në interkulturalitet
- 78 8) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në një rrjet global në shërbim të misionit
- 80 9) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në shkëlqyeshmërinë njerëzore
- 83 10) Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në formimin e vazhdueshëm
- 85 Përmbyllje**
- 88 Shtojcë: një përshkrim skematik**



CURIA GENERALIZIA DELLA COMPAGNIA DI GESÙ

Jesuit Schools: A Living Tradition

2019/25

TO THE WHOLE SOCIETY

Dear Friends in the Lord,

On December 8, 1986, during the celebration of the 400th Anniversary of the first Ratio Studiorum, Fr. General Peter-Hans Kolvenbach wrote to all Major Superiors to announce the publication of the document *Characteristics of Jesuit Education* as a continuation of the educational tradition that the Society of Jesus began with the Ratio. *Characteristics* was not intended to be a new Ratio Studiorum. Rather, according to Fr. Kolvenbach's words, it aimed to provide "a common vision and a common sense of purpose... a standard against which we measure ourselves."

Fr. Kolvenbach hoped that this document could assist in the necessary discernment to find the most suitable means "to accomplish faithfully and effectively the mission received, taking into account continually changing circumstances" (Fr. Kolvenbach, letter of December 8, 1986 quoting his own letter on *Apostolic Discernment in Common*, n°32, dated November 5, 1986).

Seven years later, in 1993, Fr. Kolvenbach introduced a new document, *Ignatian Pedagogy: A Practical Approach*, better known as the *Ignatian Pedagogical Paradigm*, that provided a pedagogical style for the classroom embodying the characteristics described in the previous document.

No doubt, these two documents have greatly contributed to the processes of discernment and renewal that have made our schools, and many other Jesuit institutions these documents influenced, better adapted to the changing circumstances of our world and the needs of the new generations we educate.

Today I want to present a new document, *Jesuit Schools: a Living Tradition in the 21ST Century – An Ongoing Exercise of Discernment*. The document follows this tradition of assisting our educational apostolate in reflecting and discerning the particular challenges and opportunities of our time. It continues the necessary process of renewal, innovation and re- imagination that our education requires during this change of epoch that we experience today. The best tribute that we can offer to our long tradition in education is to explore new models, creative and imaginative ways to offer our spiritual vision and educational experience to our students and their families. Thus, the title of the document reflects well its purpose: to renew our living tradition in education as an ongoing exercise of discernment.

This document must be seen within the framework of the process of discernment that our educational apostolate has kept alive since *Characteristics* and the *Ignatian Pedagogical Paradigm* were first published. This process has continued more recently with *a cycle of global gatherings*: a Colloquium in Boston in 2012, an International Seminar in Manresa in 2014 and the First Congress



of Jesuit Education Delegates – JESEDU-Rio in Rio de Janeiro in 2017. The process will continue with a Second Colloquium in Jogjakarta, Indonesia, in 2020 with the framework of the Universal Apostolic Preferences as an important dimension of this discernment.

This document provides 10 key identifiers of Jesuit Schools. These are another important element to help in the reflection about what makes a Jesuit school today Jesuit, enabling us to navigate the challenge of keeping our identity to serve our mission of reconciliation and justice central to what we do and who we are. Of particular importance today is identifier number 2: *committed to creating a safe and healthy environment for all*. Our schools have been implementing policies and protocols to avoid, identify and respond to any kind of abuse. The challenge is to continue this path and model the necessary cultural change that our societies require to create safe and healthy environments for all.

The *Living Tradition* does not replace the previous documents; rather, it complements and updates them as an ongoing exercise of discernment. The three should be taken together as the contemporary framework of Jesuit Education. The *Living Tradition* wants also to respond to the acceleration of change that we experience today, and that is why the document itself is an unfinished discernment, *a living text* that invites educators in our schools to enrich it with their reflections, experiences and contributions. In this sense, this is an open-ended document that models the discernment it aims to inspire, and it wants to provide guidelines to continue the *education of men and women for and with others* in the context of the human excellence that distinguishes our educational tradition.

I want to thank the members of the International Commission on the Apostolate of Jesuit Education (ICAJE) for their work during the past 8 years to produce this document. As with the previous documents on education, the *Living Tradition* has been enriched by numerous drafts, discussions, worldwide feedback, consultations and the participation of specialized Ignatian educators.

Now, the challenge is to make the document an effective tool to animate the necessary discernment for our apostolate of education. The Second Colloquium JESEDU-Jogja2020, as the first global gathering of the new cycle, will introduce the document for an experience of virtual colloquium at the beginning of 2020. I ask Major Superiors, after the document is introduced, to ensure that it is widely known, distributed, used and discussed in their provinces and regions by all educators and everyone involved in the schools. Provincial assistants for education will have good ideas about the best ways to make this document available to the schools, to inspire the ongoing discernment on how best to conduct our education today in the local, regional and global realities in which we serve. The document should be presented within the framework of the *Universal Apostolic Preferences* and the renewal of the apostolic vigor required by them, as I have presented to you in previous letters.

Yours sincerely in the Lord,

Arturo Sosa, S.I.
Superior General

Rome, November 5, 2019
Feast of all the Saints of the Society
(Original: English)

2019/25

Gjithë Shoqërisë

Shkollat e Jezuitëve: një traditë e gjallë në shekullin XXI

Të dashur miq në Zotin,

më 8 dhjetor 1986, gjatë kremtimit të 400-vjetorit të *Ratio Studiorum*-it të parë, Ati i Përgjithshëm Peter-Hans Kolvenbach-u u shkroi të gjithë Eprorëve të mëdhenj për të njoftuar botimin e dokumentit *Karakteristikat e Edukimit të Jezuitëve* si një vazhdimësi e traditës edukative që Shoqëria e Jezusit filloi me *Ratio*-n. Karakteristikat nuk synonin të ishin një *Ratio Studiorum* i ri. Përkundrazi, sipas fjalëve të Atë Kolvenbach-ut, ai tekst synonte të jepte “një vizion dhe domethënie të përbashkët të qëllimit [...] një standard me të cilin të masnim veten”.

Atë Kolvenbach-u shpresonte që ky dokument do të ndihmonte në shohitjen e nevojshme për të gjetur mjetet më të përshtatshme “për të përmbushur me besnikëri dhe në mënyrë të efektshme misionin, duke marrë parasysh rrethanat vazhdimisht në zhvillim” (Atë Kolvenbach-u, letra e datës 8 dhjetor 1986, duke cituar letrën e tij mbi *Shohitjen e Përbashkët Apostolike*, nr. 32, datë 5 nëntor 1986).

Shtatë vjet më vonë, në vitin 1993, Atë Kolvenbach-u prezantoi një dokument të ri, *Pedagogjia Injacione: Hyrje në Praktikë*, i njohur më mirë si “Paradigma Pedagogjike Injacione”. Ky tekst ofroi një stil pedagogjik didaktik që mishëron karakteristikat e përshkruara në dokumentin e mëparshëm.

Pa dyshim, këto dy dokumente kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në proceset e shohitjes dhe të ripërtëritjes që i kanë bërë shkollat tona - dhe shumë institucione të tjera jezuite të ndikuara prej tyre - më të përshtatshme për t’iu përgjigjur rrethanave në ndryshim të botës sonë dhe nevojave të brezave të rinj që edukojmë.

Sot dua të prezantoj një dokument të ri, *Shkollat e Jezuitëve: një traditë e gjallë në shekullin XXI - Një ushtrim i vazhdueshëm shohitjeje*. Dokumenti vazhdon traditën e shoqërimit të apostullimit tonë edukativ në reflektimin dhe shohitjen e sfidave dhe të mundësive të veçanta të kohës sonë, dhe çon përpara procesin e nevojshëm të ripërtëritjes, të inovacionit dhe të ri-imagjinimit që kërkon edukimi ynë në ndryshimin aktual të epokës. Kontributi më i mirë që mund t’i ofrojmë traditës sonë të gjatë edukative është eksplorimi i modeleve dhe i mënyrave të reja krijuese dhe imagjinuese për të ofruar vizionin tonë shpirtëror dhe përvojën tonë edukative për nxënësit tanë dhe familjet e tyre. Prandaj, titulli i dokumentit pasqyron mjaft mirë qëllimin e tij: të ripërtërijë traditën tonë “të gjallë” në edukim si një ushtrim i vazhdueshëm shohitjeje.

Ky dokument duhet parë në kontekstin e procesit të shohitjes që apostullimi ynë edukativ ka mbajtur gjallë që kur u botuan për herë të parë *Karakteristikat* dhe *Paradigma Pedagogjike Injacione*. Ky proces kohët e fundit ka parë organizimin e një cikli takimesh globale: një *Colloquium* në Boston në vitin 2012, një *Seminar Ndërkombëtar* në Manreza në vitin 2014 dhe *Kongresi* i parë i *Delegatëve të Edukimit të Jezuitëve - JESEDU-Rio*, në Rio de Zhaneiro, në vitin 2017. Procesi do të vazhdojë me një *Colloquium* të dytë në Jogjakarta, Indonezi, në vitin 2020, i cili paraqet kuadrin e *Preferencave Apostolike Universale* si një dimension të rëndësishëm të kësaj shohitjeje.

Ky dokument ofron 10 identifikues-kyç të shkollave të Jezuitëve. Ato përbëjnë një element tjetër të rëndësishëm që na ndihmon të reflektojmë mbi atë që sot e bën "jezuite" një shkollë të Jezuitëve, gjë që do të na ndihmojë ta kapërcejmë sfidën e ruajtjes së identitetit tonë - t'i shërbejmë misionit tonë të pajtimit dhe të drejtësisë - në qendër të asaj që bëjmë dhe që jemi. Një rëndësi të veçantë sot ka identifikuesi numër 2: "të angazhuar për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë". Shkollat tona kanë zbatuar politika dhe protokolle për të parandaluar, për të identifikuar dhe për t'iu përgjigjur çdo lloj abuzimi. Sfida është ta vazhdojmë këtë rrugë dhe ta formësojmë ndryshimin e nevojshëm kulturor që shoqëritë tona kërkojnë për të krijuar mjedise të sigurta dhe të shëndetshme për të gjithë.

Një traditë e gjallë nuk i zëvendëson dokumentet e mëparshme; përkundrazi, i integron dhe i përditëson ato si një ushtrim i vazhdueshëm shoshitës. Prandaj, të tre dokumentet duhet të konsiderohen si "korniza bashkëkohore" e edukimit të jezuitëve. *Një traditë e gjallë* dëshiron t'i përgjigjet përshpejtimit të ndryshimit që përjetojmë sot dhe kjo është arsyeja pse vetë dokumenti është një shoshitje "e papërfunduar", një "tekst i gjallë" që i fton edukatorët e shkollave tona ta pasurojnë atë me reflektimet, përvojat dhe kontributet e tyre. Në këtë kuptim, ky është një dokument i hapur që modelon një shoshitje, e cila synon të shërbejë si frymëzim dhe të japë udhëzime që na mundësojnë të vazhdojmë të edukojmë "burra dhe gra për dhe me të tjerët" brenda kontekstit "të shkëlqyeshmërisë njerëzore dhe shpirtërore" që dallon traditën tonë edukative.

Dua të falënderoj anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar për Apostullimin Edukativ të Jezuitëve (ICAJE) për punën që kanë bërë gjatë tetë viteve të fundit për hartimin e këtij dokumenti. Ashtu si edhe dokumentet e mëparshme mbi edukimin, *Një traditë e gjallë* është rezultat i një pune të pandërprerë mbi drafte, diskutime dhe reagime të shumta nga e gjithë bota, me konsultime dhe kontribute nga shumë edukatorë të specializuar injacianë.

Tani, sfida është që ky dokument të bëhet një mjet i efektshëm për të gjallëruar shoshitjen e nevojshme për apostullimin tonë edukativ. *Colloquium-i* i dytë *JESEDU-Jogja2020*, si tubimi i parë global i ciklit të ri, do të paraqesë dokumentin për një përvojë "colloquium-i virtual" në fillim të vitit 2020. Kërkoj nga Eprorët e Lartë, pasi të jetë paraqitur dokumenti, të kujdesen që ai të njihet, të shpërndalet, të përdoret dhe të diskutohet nga të gjithë edukatorët dhe nga të gjithë ata që janë të përfshirë në institucionet edukative të Krahinave dhe të Rajoneve të tyre. Delegatët për Edukimin do të shohin mënyrën më të mirë për ta vënë këtë dokument në dispozicion të shkollave, për të frymëzuar shoshitjen në vazhdim se si ta zhvillojmë më mirë edukimin tonë në realitetet lokale, rajonale dhe globale në të cilat shërbejmë. Dokumenti duhet të paraqitet brenda kuadrit të *Preferencave Apostolike Universale* dhe të ripërtëritjes së vrullit apostolik që ato kërkojnë, siç ju kam shkruar në letrat e mëparshme.

I Juaji në Krishtin

Atë Arturo Sosa S.I.
Epror i Përgjithshëm

Romë, 5 nëntor 2019
Festa e të Gjithë Shenjtërve të Shoqërisë
(originali: anglisht)

Hyrje:

Bashkëbisedimi duhet të vazhdojë...

ICAJE-ja (International Commission on the Apostolate on Jesuit Education) ka punuar që nga viti 2011 për dokumentin që ju keni tani në dorë. Që nga fillimi, reflektimi ka qenë rreth mënyrës se si mund t'i ndihmojmë bashkësitë shkollore që të kuptojnë dhe t'i përgjigjen kontekstit tonë aktual, si dhe të vazhdojnë reflektimin e gjatë që Jezuitët e parë filluan në shekullin e gjashtëmbëdhjetë. Ky reflektim i gjatë ka çuar në hartimin e dokumenteve të rëndësishme që kanë udhëhequr edukimin e Jezuitëve ndër shekuj. *Ratio Studiorum*-i i vitit 1599 ishte i pari nga këto dokumente. *Ratio*-ja përshkruan një model edukativ që i ka nxitur shkollat tona dhe ka krijuar një ndjenjë njësie rreth një kurrikule dhe strukture të përbashkët shkollore. Suksesi dhe kufizimet e tij janë debatuar gjerësisht përgjatë shekujve. Jezuitëve - dhe kolegëve të tyre në apostullim - iu deshën disa shekuj përpara se të binin dakord për një dokument të ri që u përgjigjej konteksteve të reja: dokumenti *Karakteristikat e Edukimit të Jezuitëve*, i vitit 1986, përmbledh ndjenjën e përbashkët mbi atë që është qendrore dhe karakteristike e edukimit tonë në fund të shekullit XX. Ky dokument u ka mundësuar shkollave që të ndërtojnë një njësi të re rreth një identiteti të përbashkët, identitet që zhvillohet në shumë modele të ndryshme dhe u përgjigjet konteksteve të ndryshme lokale dhe kombëtare. *Karakteristikat* u pritën me shumë entuziazëm, aq sa edukatorët e shkollave të Jezuitëve filluan të kërkonin një dokument tjetër, ku të sqarohet stili pedagogjik që mund të mishëronte 28 karakteristikat e renditura aty. Rezultati ishte vëllimi *Pedagogjia Injacione: Hyrje në Praktikë*, i vitit 1993. Ky dokument është bërë një gur miliar pedagogjik për shumë breza edukatorësh që punojnë me zell në çdo cep të planetit për të vazhduar traditën e gjallë të edukimit të Jezuitëve dhe për ta zbatuar atë në vendin kyç ku zhvillohet realisht: në klasë.

Megjithatë, edukimi i Jezuitëve, si vetë historia njerëzore, është një traditë e gjallë që kërkon sy, veshë dhe zemra të hapura. Ky dokument dëshiron të jetë një ftesë për të vazhduar bashkëbisedimin, në të gjitha nivelet, në shkollat dhe rrjetet tona shkollore. Në ICAJE, hezitojmë pak ta quajmë "dokument", pasi duam që ky të jetë një *tekst i gjallë* që mund të na ndihmojë të mbajmë hapin me epokën tonë ku ndryshimi i shpejtë është normalja e re, me të gjitha aspektet pozitive dhe problematike që kjo gjë sjell. Nuk duam një dokument statik, por një tekst që i frymëzon, i lëviz dhe i inkurajon mësuesit tanë, drejtuesit didaktikë dhe edukativë, dhe bashkësitë shkollore, për t'i bërë ballë në mënyrë proaktive kontekstit tonë, botës sonë, sfidave dhe mundësive tona. Kjo është arsyeja pse ky tekst do të botohet kryesisht elektronikisht: ai kërkon një ushtrim të vazhdueshëm të shoshitjes që na fton në mënyrë krijuese, të guximshme dhe bujare, për ta vënë në praktikë teorinë në shkollat tona dhe për ta vazhduar traditën tonë me

energji dhe zell të përtërirë. Për ta lehtësuar këtë proces, të gjitha seksionet e dokumentit ofrojnë pyetje shoshitëse të hartuara për të inkurajuar dëgjimin, diskutimin, reflektimin dhe krijimtarinë.

ICAJE-ja dëshiron të shprehë mirënjohjen e saj për bashkëpunëtorët e shumtë që bënë të mundur këtë dokument. Ky reflektim filloi në vitin 2011 dhe në të u përfshinë shumë aktorë të rëndësishëm: anëtarë të ndryshëm të ICAJE-së përgjatë këtyre viteve, shokë të shumtë bujarë nga 6 rajonet e Shoqërisë që dhanë komentet fillestare, specialistë që ofruan këshillat dhe ekspertizën e tyre në draftet e mëpasshme, si dhe grupin mbështetës të Sekretariatit për Edukimin të Kuries së Përgjithshme që shoqëroi krejt procesin. Mirënjohja jonë e veçantë shkon për Atë John O’Keefe-n S.J. dhe ekipin e tij, dhe për William Kemeza-n, për kontributin e tyre të rëndësishëm që dokumenti të ketë formatin dhe stilin aktual. Kontributet e tyre kanë bënë ndryshimin!

Arsyeja e vetme pse Shoqëria e Jezusit është e angazhuar për të vazhduar apostullimin e saj edukativ është bindja se, sot si dje, shkollat janë hapësira të privileguara për të përmbushur misionin tonë të pajtimit dhe të drejtësisë të identifikuar nga katër Preferencat Apostolike Universale për vitet 2019-2029 të shpallura nga Ati i Përgjithshëm:

1. **Të tregohet rruga drejt Hyjit nëpërmjet Ushtrimeve Shpirtërore dhe shoshitjes.**
2. **Të ecet së bashku me të varfrit, të përjashtuarit nga bota, të plagosurit në dinjitetin e tyre, në një mision pajtimi dhe drejtësie.**
3. **Të shoqërohen të rinjtë në krijimin e një të ardhmeje shprese.**
4. **Të bashkëpunohet për t’u kujdesur për Shtëpinë tonë të Përbashkët.**

Hyji vazhdoftë ta bekojë përpjekjen e rëndësishme apostolike, që bëjnë shkollat tona për t’i ftuar brezat e rinj që t’ia hapin jetën e tyre Hyjit dhe të përqafojnë edukimin tërësor të personit brenda traditës sonë humaniste. Vazhdoftëshim rrugëtimin magjepsës të edukimit të Jezuitëve dhe marrshim pjesë në reflektimin që i mundëson edukimit të Jezuitëve të vazhdojë të jetë një traditë të nxëni dhe jete.

José A. Mesa S.J.

Sekretar Botëror për Edukimin

Shoqëria e Jezusit



Anëtarët aktualë të ICAJE-s

José A. Mesa S.J.

President, Sekretar Botëror për Edukimin (Secondary and Pre-secondary) të Shoqërisë së Jezusit

William Muller S.J.

Drejtor ekzekutiv i JSN-së (Jesuit Schools Network)
Konferenca e Kanadasë dhe e Shteteve të Bashkuara

Ilse Dekker

Drejtor i JECSE-së (Jesuit European Commission for Primary and Secondary Education)

Sunny Jacob S.J.

Sekretar për Arsimimin Universitar për JEASA-në
(Jesuit Educational Association of South Asia)

Saúl Cuautle Quechol S.J.

President i FLACSI-së (Latin American Federation of Jesuit Schools)

Johnny Go S.J.

Sekretar për Arsimin JCAP-Education (Jesuit Conference of Asia Pacific)
Asistent për misionin dhe identitetin, Sekretariati për Edukimin

Joseph Arimoso S.J.

Koordinator JASBEAM (Jesuit Association of Secondary
and Basic Education in Africa and Madagascar)

Sekretariati

Catharine Steffens

Asistent i nismave globale

Rafael Galaz


Asistent i projekteve speciale

Educate Magis

Éamonn McGuinness

Drejtor i bashkësisë *Educate Magis*

- (1) Sot po përjetojmë fenomenin e jashtëzakonshëm të globalizimit: komunikim i menjëhershëm; transport i shpejtë i njerëzve dhe i mallrave në mbarë botën që krijon lidhje dhe shkatërrime të papara në të njëjtën kohë: ekonomike, kulturore, politike, ekologjike dhe shpirtërore.
- (2) Globalizimi ka sjellë shumë përfitime. Për shembull, mësimi *online* është tani i disponueshëm në shumë bashkësi të largëta dhe të varfra; në komunitetin shkencor, monitorimi i të dhënave dhe shkëmbimi i rezultateve kanë ndihmuar në mbrojtjen e disa prej specieve tona më të rrezikuara.
- (3) Shkollat tona kanë përfituar shumë nga globalizimi dhe nga mundësia për t'u mbledhur, për të reflektuar dhe për të punuar së bashku. Cikli i parë i takimeve të fundit globale - *Zbulimi i Potencialit tonë Apostolik* - dëshmon për këtë gjë. Këto takime globale (*Colloquium* - Seminar - Kongres) kanë ripërtërirë entuziazmin dhe kanë sjellë një vetëdije të re për atë që mund të arrijmë kur punojmë së bashku. Cikli i dytë - *Të ecim si një Rrjet Global në Shërbim të Misionit* - fillon pikërisht me këtë dokument i cili do të përdoret për përgatitjen e *Colloquium-it II JESEDU-Jogja2020*.



- (4) Përkundrazi, shumë bashkësi, duke filluar nga qeveritë tek bashkësitë fetare, kanë luftuar për t'u përshtatur. Në shumë raste, sfidat e ndryshimit të shpejtë kanë çuar në riorganizime, me përpjekjen për të ngritur mure ekonomike, kulturore, fetare, madje edhe deri te vullnesa për të përdorur dhunë. Edhe këto janë shenja të kohës.
- (5) Duhet theksuar se sot apostullimi ynë edukativ paraqitet si veçanërisht i përshtatshëm për këtë moment historik. Kemi një rrjet shkollash në mbarë botën të rrënjosura në idealin e fesë se Hyji mund të gjendet në çdo kulturë, në çdo nivel ekonomik, në kërkimin fetar të çdo personi, në çdo formë jete. Si pjesë e apostullimit të Jezuitëve, shkollat kanë thirrjen që të formojnë të rinj udhëheqës të rrënjosur në misionin e Ungjillit: pajtimi nëpërmjet drejtësisë dhe kujdesi i pasionuar ndaj krejt krijimit.
- (6) Tani është koha të reflektojmë dhe të veprojmë duke pasur parasysh se jemi një sistem ndërkombëtar arsimimi i krijuar prej paraardhësve tanë Jezuitë dhe laikë gjatë 450 viteve të fundit.

Një ushtrim në shoshitje

- (7) Ky dokument është për të gjithë ata që marrin pjesë në misionin tonë edukativ, pasi të gjithë - secili individualisht, laikë dhe Jezuitë, dhe të gjithë së bashku si bashkësi - kemi një përgjegjësi që përfshin gjithë botën. Shkollat tona dhe secili prej nesh individualisht janë bekuar me këtë detyrë.
- (8) Qëllimi i këtij dokumenti është t'i ftojë të gjitha palët e interesuara në shkollat e Jezuitëve që të nisin, të vazhdojnë ose të ripërtërijnë një proces shoshitjeje si një mënyrë për t'iu përgjigjur kontekstit tonë historik, rrënjëve tona dhe identitetit tonë. Jemi të vetëdijshëm, si kurrë më parë, për natyrën e ndryshueshmërisë së historisë, të përshpejtimit të ndryshimit dhe të sfidave të shumta me të cilat po përballemi. Megjithatë, jemi të thirrur që të rizbulojmë se trashëgimia jonë injaciane na ofron mjetet e duhura për ta gjetur Hyjin në këtë kontekst dhe për të vazhduar të ofrojmë një edukim cilësor në traditën humaniste të Jezuitëve për t'i përgatitur nxënësit që të bëhen agjentë ndryshimi në shërbim të së mirës së përbashkët.
- (9) U kërkojmë drejtuesve të veprave tona edukative që të gjejnë kohë për të organizuar një proces me qëllim që mësuesit tanë dhe stafi ynë jo-mësimor të marrë pjesë në një shoshitje për secilën prej 28 seksioneve të mëposhtme, të cilat kërkojnë reflektim dhe veprim për një të mirë më të madhe. Kjo shoshitje duhet parë, në përgjithësi, si një vazhdim i traditës sonë të gjallë edukative dhe, në veçanti, si një vazhdim i shoshitjes së kërkuar nga *Action Statement*-i i JESEDU-së së Rios, së vitit 2017, dhe nga Preferencat tona Apostolike Universale.



- (10) Bëhet fjalë për një angazhim të madh kohe për institucionet tona dhe për një punë “thelbësore”. Në fakt, është thelbësore para së gjithash të angazhohemi në një reflektim të shoqëruar me lutje për të shoshitur rrugën tonë nga brenda dhe për të mirën e institucioneve tona, domethënë të komunikojmë dhe të bashkëpunojmë me rrjetin tonë global. Është thelbësore ta dëgjojmë njëri-tjetrin mes zonave të ndryshme gjeografike, t’i forcojmë lidhjet tona, të punojmë për të arritur një të mirë më të madhe. Prandaj, të ndërmarrim çdo nismë që mund të shërbejë një përgjigje ungjillore ndaj shenjave të reja të kohëve.

Të rrënjosur në Ushtrimet Shpirtërore

(11) Pika jonë e nisjes për reflektim vjen nga Ushtrimet Shpirtërore, një lente që përdorim për të shoshitur thirrjen e Krishtit sot.

(12) **A) Një vizion i botës me sytë e Hyjit**

Në fillim të Javës së Dytë të Ushtrimeve, Shën Injaci e fton atë që i merr Ushtrimet që ta shikojë botën bashkë me Trininë - Hyjin që krijon, që na do dhe që na mbështet.

(13) Si edukatorë, soditim vështrimin e Trinisë së Shenjtë mbi botën tonë. Shohim gjallërinë e rinisë që dëshiron jetën e vet. Shohim njerëz që shijojnë bukurinë e krijimit dhe përpiqen ta gjejnë Hyjin në veprimtaritë e tyre të përditshme. Vëmë re një rritje të shpejtë shkencore, teknologjike dhe ekonomike; shohim shumë potencial për ta përmirësuar jetën në tokë. Megjithatë, shohim edhe dhunë, shfrytëzim brutal dhe padrejtësi. Intoleranca etnike dhe fetare, fundamentalizmi dhe diskriminimi cenojnë dinjitetin njerëzor, përkeqësojnë pabarazitë dhe përjashtojnë shumë njerëz nga shoqëria, veçanërisht gratë dhe fëmijët.

(14) Çekuilibra seriozë dhe degradime mjedisore, të rënduara nga një kulturë “përdor e hedh”, çojnë në një planet të helmuar dhe të ndotur. Përshpirtëria Injaciene i mban polaritetet në tension në këtë botë të bukur, por të trazuar: soditjen dhe veprimin, të drejtat dhe përgjegjësitë.


(15) Edukimi i Jezuitëve ka të bëjë me edukimin e nxënësve për të bashkëndarë këndvështrimin e Trinisë që e shikon botën dhe që kërkon ta bëjë atë më të dashur dhe më të drejtë. Kjo është dhurata që shkollat e Jezuitëve i ofrojnë brezit të ardhshëm.

B) Biseda: “Çfarë kam bërë për Krishtin? Çfarë po bëj për Krishtin? Çfarë duhet të bëj për Krishtin?”

- (16) Siç do ta shihni, “**Një traditë e gjallë**” është konceptuar për t’i dhënë fill një reflektimi brenda apostullimit tonë. Në Ushtrimet Shpirtërore, Shën Injaci e fton atë që i merr Ushtrimet të qëndrojë përpara kryqit dhe të shqyrtojë tri pyetje, të cilat ende jehojnë në traditën tonë shpirtërore: “Çfarë kam bërë për Krishtin?, Çfarë bëj për Krishtin?, Çfarë duhet të bëj për Krishtin?” (U.SH., nr. 53).
- (17) “Çfarë kemi bërë për Krishtin?”. “**Një traditë e gjallë**” ripërshkon tridhjetë vitet e fundit të ndryshimeve të thella, përbërë nga mundësi të reja për të mirën dhe nga kërcënime ndaj vlerave të rrënjësura thellë. Të reflektojmë për mënyrën se si misioni i edukimit të Jezuitëve është ripërtërirë në dokumente dhe nisma të reja.
- (18) “Çfarë po bëjmë për Krishtin?”. “**Një traditë e gjallë**” i shikon realitetet aktuale në botë dhe në shkollat tona të lidhura me statistikat, dokumentet dhe burimet aktuale.
- (19) “Çfarë duhet të bëjmë për Krishtin?”. “**Një traditë e gjallë**” sugjeron që sot, në këtë botë të ndërlydhur, duke pasur parasysh realitetet aktuale, ekzistojnë elemente thelbësore identifikuese që duhet të jenë pjesë e secilës prej shkollave tona jezuite në botë, pavarësisht kushteve lokale apo kontekstit.

Struktura e dokumentit

- (20) “Një traditë e gjallë” u kërkon të gjithë edukatorëve injacianë:



- (21) Në **Pjesën e Parë: Dokumente bazë** të reflektojnë mbi tri dokumente bazë botuar tridhjetë vitet e fundit:

Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit (1986);

Pedagogjia Injacione: Hyrje në Praktikë (1993);

Preferencat Apostolike Universale të Shoqërisë së Jezusit (2019);

dhe dokumente të tjera të rëndësishme.

- (22) Në **Pjesën e Dytë: Realiteti i ri global**

të reflektojnë mbi disa prej ndryshimeve më të mëdha që kanë ndodhur në këtë periudhë:

- në realitetin socio-politik;
- në edukim;
- në praktikën fetare;
- në Kishën katolike;
- në Shoqërinë e Jezusit.

- (23) Në **Pjesën e Tretë: Elemente identifikuese globale të shkollave të Jezuitëve** për të rritur pjesëmarrjen e shkollave tona në realitetin e ri global, ky dokument përfshin 10 elemente identifikuese, që duhet të jenë të pranishme në të gjitha shkollat e Jezuitëve.

- (24) Shkollat e Jezuitëve duhet të jenë katolike dhe të angazhuara në:

1. formimin e thellë në fe dhe në dialog me besime fetare dhe vizione të tjera të botës;
2. krijimin e një mjedisi shkollor të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë;
3. qytetarinë globale;
4. kujdesin ndaj krijimit;
5. drejtësi;
6. arritjen e saj prej të gjithëve;

- 7. ndërkulturalitet;
- 8. një rrjet global në shërbim të misionit;
- 9. shkëlqyeshmërinë njerëzore;
- 10. mësimnxënien e vazhdueshme.

- (25) “Një traditë e gjallë” është shtypur në letër; versioni anglisht, frëngjisht dhe spanjisht është i disponueshëm edhe në adresën www.educatemagis.org. Ky “community” në rrjet lidh edukatorët e Jezuitëve me frymëzim injacian nga e gjithë bota.
- (26) Në versionin online, në fund të çdo seksioni, edukatorët mund ta pasurojnë “Një traditë të gjallë” përmes bashkëbisedimeve ndërvepruese, videove, fotografive dhe link-eve, në mënyrë që të pasqyrojnë larmishmërinë e pasur të gjashtë Konferencave të Jezuitëve: Afrikë dhe Madagaskar, Azi-Paqësor, Evropë, Amerikë Latine, Amerikë e Veriut dhe Azi Jugore.

Pjesa e Parë: Dokumente bazë



Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit (1986)¹



- (27) Në shtator të vitit 1980, një grup i vogël ndërkombëtar Jezuitësh dhe laikësh u mbledhën në Romë për të diskutuar çështje të shumta dhe të rëndësishme në lidhje me edukimin e mesëm në shkollat e Shoqërisë së Jezusit. Këto diskutime kulmuan disa vite më vonë me botimin e dokumentit bazë me titull *Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit*. Eprori i Përgjithshëm Atë Peter Hans Kolvenbach-u S.J. e shpalli dokumentin më 8 dhjetor 1986. Në letrën e tij, Atë Kolvenbach-u përshkruan qëllimin e dokumentit:
- (28) **“Dokumenti *Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit* mund t’i ndihmojnë të gjithë ata që punojnë në edukimin e Jezuitëve që të ushtrojnë detyrën thelbësore të shoshitjes apostolike. Mund të jetë bazë për një reflektim të ri mbi përvojën e apostullimit edukativ dhe, nën dritën e këtij reflektimi, për vlerësimin e politikave dhe të praktikave shkollore: jo vetëm negativisht (“Çfarë po bëjmë gabim”), por sidomos pozitivisht (“Si mund të bëjmë më mirë?”). Kjo duhet të marrë parasysh rrethanat lokale “në zhvillim të vazhdueshëm”: vendet ose rajonet individuale duhet të reflektojnë mbi kuptimin dhe lidhjet e *Karakteristikave* me situatat e tyre lokale dhe për këtë arsye të hartojnë dokumente plotësuese që e përshtasin këtë dokument universal me nevojat konkrete dhe specifike të tyre”.**
- (29) Dokumenti përmban 28 karakteristika të edukimit të Jezuitëve, të organizuara në 9 seksione, të cilat nxjerrin në pah përvojën shpirtërore të Injacist si burimi i fundit i edukimit të Jezuitëve.

Ushtrimi 1. Për shoshitjen:


- Në çfarë mënyre ti apo institucioni yt e keni përdorur këtë dokument?
- Mes 28 karakteristikave të edukimit të Jezuitëve të identifikuar në dokument, cilat mendon se duhet t’i përforcosh në institucionin tënd dhe në çfarë mënyre?
- Si do ta përdorësh ti apo apostullimi yt edukativ në të ardhmen?

1. http://www.sjweb.info/documents/education/characteristics_it.pdf

B. Pedagogjia Injacione: Hyrje në Praktikë (1993)²




- (30) Shtatë vjet më vonë, më 31 korrik 1993, Atë Kolvenbach-u shpalli dokumentin *Pedagogjia Injacione: Hyrje në Praktikë*, një tekst që synon të plotësojë *Karakteristikat* dhe të ndërtojë mbi to. Duke njohur qasjet e ndryshme të shkollave të Jezuitëve, Pedagogjia Injacione propozoi një qasje fleksibël bazuar në parimet e përgjithshme të Ushtrimeve Shpirtërore.



- (31) I menduar për mësuesit, ky tekst porosit një stil mësimdhënieje që karakterizohet nga pesë “dimensione”:
1. zotërimi i një kuptimi të thelluar të kontekstit ku zhvillohet mësimdhënia;
 2. krijimi i përvojave që zgjerojnë intelektin dhe imagjinatën e nxënësve;
 3. nxitja e një zakoni reflektimi të vazhdueshëm për të thelluar çfarëdo përvoje;
 4. ofrimi i mundësive për të vënë në veprim vlerat dhe kompetencat e fituara, me qëllim që të ndodhë një shndërrim pozitiv te nxënësi, mësuesi dhe bota. Këto veprime duhet të jenë në shërbim të Ungjillit, pasi Shën Injaci pohon se dashuria tregohet më shumë me veprime, sesa me fjalë;
 5. angazhimi për një vlerësim të pasur dhe të hartuar mirë të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, bashkuar me vullnesën për të ndryshuar dhe për të modifikuar atë që është e nevojshme.²

2. http://www.sjweb.info/documents/education/pedagogy_it.pdf

(32) Dimensionet e Paradigmës Pedagogjike Injacione

**Ushtrimi 2. Për shohsitjen:**

- Si e ke praktikuar ti apo institucioni yt Pedagogjinë Injacione?
- Çfarë dobie ke pasur ti prej përdorimit të Paradigmës Pedagogjike Injacione?
- Çfarë vështirësish ke ndeshur në praktikimin e saj?
- Si do ta përdorësh në të ardhmen ti apo institucioni yt edukativ?

C. Preferencat Apostolike Universale të Shoqërisë së Jezusit (2019)



- (33) Më 19 shkurt 2019 Ati i Përgjithshëm Arturo Sosa shpalli *Preferencat Apostolike Universale të Shoqërisë së Jezusit*.³

Këto preferenca janë fryt i një zgjedhjeje, e cila zgjati gati dy vjet, në të cilën u ftuan të merrnin pjesë të gjithë anëtarët e Shoqatës së Jezusit dhe shumë kolegë laikë. Ato do të udhëheqin të gjitha veprat e Shoqërisë për dhjetë vitet e ardhshme.

- (34) Siç do të shihet nga kalimet e përzgjedhura më poshtë dhe të shënuara në këtë ushtrim, secila prej këtyre katër preferencave universale pohon dhe forcon procesin, përshkrimet, sfidat dhe thirrjet për veprim të dokumentit “Një traditë e gjallë”. Katër preferencat universale janë:

Preferenca Apostolike Universale 2019 - 2029

**Të tregojmë ecjen
kah Hyji nëpërmjet
Ushtrimeve Shpirtërore
dhe shoshitjes**

**Të bashkëpunojmë
për t’u kujdesur
për Shtëpinë tonë
të përbashkët**



**Të ecim së bashku me
të varfrit, të përjashtuarit
e botës, me ata që janë
plagosur në dinjitetin e tyre,
në një mision pajtimi
dhe drejtësie**

**T’i shoqërojmë
të rinjtë në krijimin
e një të ardhmeje shprese**

3. <https://jesuits.global/it/riguardo-a-noi/preferenze-apostoliche-universali>

- (35) **1. Të tregojmë ecjen kah Hyji nëpërmjet Ushtrimeve Shpirtërore dhe shoshitjes⁴**
- (36) Si besimtarë, ndjejmë një nevojë urgjente për t'i kapërcyer si shekullarizmat e rinj, ashtu edhe nostalgjinë për shprehjet kulturore të së kaluarës. Vendosim të bashkëpunojmë me Kishën për ta parë shoqërinë shekullare si një shenjë të kohëve që na jep mundësinë për ta ripërtërirë praninë tonë në zemër të historisë njerëzore. Një shoqëri e pjekur e shekullarizuar krijon hapësira për dimensionet komplekse të lirisë njerëzore, sidomos të asaj fetare.
- (37) Në të njëjtën kohë, vendosim t'i ofrojmë Ushtrimet Shpirtërore në të gjitha mënyrat e mundshme, duke u dhënë shumë personave, veçanërisht të rinjve, mundësinë për të përfituar nga mundësia për të filluar ose për të përparuar në ndjekjen e Krishtit.
- (38) Gjithashtu vendosim të nxisim shoshitjen si një zakon të rregullt për ata që zgjedhin ta ndjekin Krishtin. Shoqëria e Jezusit është e angazhuar për ta praktikuar dhe për ta përhapur shoshitjen shpirtërore, personale dhe bashkësiore, si mënyra e zakonshme e marrjes së vendimeve të udhëhequra nga Shpirti Shenjt në jetën tonë, në veprat tona apostolike dhe në bashkësitë tona kishtare. Bëhet fjalë për zgjedhjen për ta kërkuar dhe për ta gjetur vullnesën e Hyjit, gjithmonë, duke e lënë veten të udhëhiqemi nga Shpirti Shenjt. Nëpërmjet shoshitjes sonë të përbashkët të preferencave apostolike, kemi përjetuar një ripërtëritje në mënyrën tonë të të ecurit. Prandaj, vendosim ta përdorim rregullisht bashkëbisedimin dhe shoshitjen shpirtërore në vënien në jetë të preferencave tona në të gjitha nivelet e misionit jetësor të Shoqërisë.
- (39) **2. Të ecim së bashku me të varfrit, të përjashtuarit e botës, me ata që janë plagosur në dinjitetin e tyre, në një mision pajtimi dhe drejtësie⁵**
- (40) Vendosim të ecim me njerëz dhe bashkësi vulnerabël, të përjashtuara, të mënjanuara dhe njerëzisht të varfëruara. Angazhohemi të ecim me viktimat e shpërdorimit të pushtetit, të abuzimit të ndërgjegjes dhe të abuzimit seksual; me të përjashtuarit e kësaj bote; me të gjithë ata që tradita biblike i njeh si të varfrit e tokës, britmës së të cilëve Zoti u përgjigjet me mishërimin e Tij lirues.

4. <https://www.jesuits.global/it/uap/il-discernimento-e-gli-esercizi-spirituali>

5. <https://jesuits.global/it/uap/camminare-con-gli-esclusi>

- (41) Pohojmë angazhimin tonë për t'u kujdesur për migrantët, të larguarit, refugjatët dhe viktimat e luftërave dhe të trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu vendosim ta mbrojmë kulturën dhe ekzistencën dinjitoze të popujve autoktonë.
- (42) Angazhohemi të ndihmojmë në eliminimin e abuzimeve brenda dhe jashtë Kishës, duke kërkuar të garantojmë që viktimat të dëgjohen dhe të ndihmohen siç duhet, që drejtësia të vendoset dhe dëmi të shërohet. Ky angazhim përfshin miratimin e politikave të qarta për parandalimin e abuzimit, formimin e vazhdueshëm të atyre që janë angazhuar në misionin dhe përpjekjet serioze për identifikimin e zanafillave sociale të abuzimit. Në këtë mënyrë, nxisim në mënyrë të efektshme një kulturë që i mbron të gjithë njerëzit vulnerabël, veçanërisht të miturit.
- (43) **3. T'i shoqërojmë të rinjtë në krijimin e një të ardhmjeje shprese⁶**
- (44) Të rinjtë përjetojnë tensionin mes shtytjes drejt homogjenitetit kulturor dhe lindjes së një shoqërie njerëzore ndërkulturore që respekton dhe pasurohet nga larmishmëria. Logjika e ekonomisë së tregut çon në homogjenitet, kurse të rinjtë aspirojnë atë larmishmëri që përkon me ushtrimin e lirisë së vërtetë dhe krijon hapësira krijuese që kontribuojnë në lindjen e një shoqërie njerëzore dhe ndërkulturore. Me këto baza, ata mund të angazhohen për ndërtimin e një kulture mbrojtëse që garanton një mjedis të shëndetshëm për fëmijët dhe të rinjtë, duke krijuar kushte që u mundësojnë të gjithëve të zhvillojnë potencialin e plotë si qenie njerëzore.
- (45) Shoqërimi i të rinjve kërkon nga ne një jetë të vërtetë, thellësi shpirtërore dhe hapje ndaj pjesëmarrjes në misionin e jetës, që i jep kuptim asaj që jemi dhe asaj që bëjmë. Me këto gatishmëri të brendshme mund të mësojmë, së bashku me të rinjtë, ta gjejmë Hyjin në çdo gjë dhe nëpërmjet mbarështimeve dhe apostullimeve tona, mund t'i ndihmojmë ta jetojnë më thellë këtë stad të jetës së tyre. Shoqërimi i të rinjve na vë në rrugën e kthimit personal, bashkësior dhe institucional.

6. <https://jesuits.global/it/uap/accompagnare-i-giovani>

- (46) **4. Të bashkëpunojmë për t'u kujdesur për Shtëpinë tonë të përbashkët⁷**
- (47) Vendosim, duke marrë parasysh kush jemi dhe mjetet që kemi, të bashkëpunojmë me të tjerët për ndërtimin e modeleve alternative të jetës bazuar në respektimin e krijimit dhe mbi një zhvillim të qëndrueshëm në gjendje për të prodhuar mallra të cilat, kur shpërndahen siç duhet, sigurojnë një jetë dinjitoze për të gjitha qeniet njerëzore në planetin tonë.
- (48) Ruajtja në kohë e kushteve të jetës në planetin tonë është një përgjegjësi njerëzore me rëndësi të madhe etike dhe shpirtërore. Bashkëpunimi ynë duhet të përfshijë si pjesëmarrjen në përpjekjet e vazhdueshme për t'i analizuar këto çështje në thellësi, ashtu edhe nxitjen e reflektimit dhe të shoshitjes që synojnë marrjen e vendimeve që ndihmojnë në shërimin e plagëve që i janë shkaktuar ekuilibrit delikat ekologjik.
- (49) Jemi veçanërisht të shqetësuar për ato treva kaq vendimtare për ruajtjen e ekuilibrit natyror që e bën të mundur jetën, siç është rajoni i Amazonës; pellgjet lumore të Kongos, të Indisë dhe të Indonezisë; dhe hapësirat e mëdha të detit të hapur. Përkujdesja në këtë mënyrë ndaj natyrës është një formë nderimi autentik i veprën krijuese të Hyjit. Duhet marrë vendime të guximshme për të shmangur dëme të mëtejshme dhe për të bërë ndryshime të nevojshme në stilin e jetës, me qëllim që të mirat e krijimit të përdoren për të mirën e të gjithëve. Duam të përfshihemi aktivisht në këtë proces.

Ushtrimi 3. Për shoshitjen:

- a. A e ke lexuar krejt dokumentin?
- b. Çfarë të nxit në mënyrë të veçantë?
- c. Çfarë të sfidon?
- d. Si e vlerëson dobishmërinë e tij?
- e. Në çfarë mënyre institucioni yt edukativ mund t'u përgjigjet këtyre Preferencave Apostolike Universale?

7. <https://jesuits.global/it/uap/prendersi-cura-della-nostra-casa-comune>



(51) Në ciklin e parë të takimeve globale kemi hartuar dy dokumente që janë bërë burime të rëndësishme për shohitjen.

(52)  **1. Edukimi i Jezuitëve synon shkëlqyeshmërinë njerëzore**

Men and Women of Conscience, Competence, Compassion and Commitment (2015). Ky dokument përmbledh diskutimet dhe shohitjen që u zhvilluan gjatë SI-PEI-it (Seminari Ndërkombëtar mbi Pedagogjinë dhe Përshpirtërinë Injacione) në Manrezë (Spanjë), në vitin 2014. Dokumenti përdor 4C-të, katër fjalë që në anglisht fillojnë me C (Conscience-Ndërgjegje, Competence-Kompetencë, Compassion-Dhembshuri, Commitment-Përkushtim) për të identifikuar elementet kyç, që përcaktojnë edukimin tërësor të personit të traditës edukative të Jezuitëve të sotëm.

(53) Në veçanti, të lexohet *Section 9, Part III*, e këtij dokumenti: “Jesuit schools are committed to Human Excellence”.

(54)  **2. JESEDU-Rio 2017 “Action statement”-i**

Nga data 15 deri më 20 tetor 2017 në Rio de Zhaneiro, Kongresi i Delegatëve të Edukimit të Jezuitëve punoi mbi një axhendë të përbashkët globale për shkollat tona, me objektivin për ta vënë në jetë rrjetin tonë edukativ si një mjet “për të vepruar si një trup universal me një mision universal” (GC 35, Dekreti 2, nr. 20). Delegatët e apostullimit edukativ të gjashtë Rajoneve jezuite të botës, së bashku me persona të tjerë të angazhuar në apostullimet edukative të Jezuitëve, u takuan në Rio de Zhaneiro të thirrur prej Sekretariatit për Edukimin e Shoqërisë së Jezusit. Diskutimi hyrës i Atit të Përgjithshëm Arturo Sosa drejtuar anëtarëve të Kongresit ka frymëzuar Action statement-in formuluar në fund të punimeve.⁸

8. http://www.sjweb.info/education/doc-news/YESEDU-Rio%202017_Action_Statement_EN_Final_171121.pdf

(55) Ky “statement” ka propozuar 13 veprime, prej të cilëve 8 janë paraqitur si përparësi, që kërkojnë përgjigje të shpejta, nga ana e të gjithë delegatëve dhe shkollave, që të bëhen realisht një trup universal me një mision universal.

(56) Delegatët janë angazhuar të vënë në jetë 13 pikat në vijim, të ndarë në katër lëme:⁹

(57) **A. Përvoja e Hyjit:**

1. Të nxitet Shqyrtimi i Ndërgjegjes në secilën prej shkollave për t’i ndihmuar nxënësit që ta dëgjojnë zërin e tyre të brendshëm dhe të mësojnë udhën e brendësisë.
2. Të punohet me shkollat për të hartuar një modul (ose disa njësi didaktike brenda kurrikulës mësimore) për një edukim ndërfaqet. Ky modul duhet t’u mundësojë nxënësve që të mësojnë të njohin besimet fetare të botës dhe të respektojnë mënyrat e ndryshme me të cilat besimet fetare shprehin dhe kremtojnë hyjnoren.
3. Të gjenden mënyrat në të cilat Përshpirtëria Injacione mund të përshtatet (duke iu referuar në mënyrë specifike Ushtrimeve Shpirtërore) me mjedisin shkollor, në mënyrë që nxënësit të fitojnë një qëndrim ndaj heshtjes së brendshme dhe praktikës së shoshitjes shpirtërore.

(58) **B. Traditë dhe inovacion:**

4. Të nxitet një proces shoshitës injacion që do të çojë në një plan inovativ për secilën shkollë dhe në një rishikim periodik, që përputhet me kontekstin lokal dhe traditën tonë.
5. Të rishikohen, bashkë me shkollat, strukturat tradicionale organizative dhe rolet, duke u kushtuar një vëmendje të veçantë stereotipeve dhe pabarazive gjinore.
6. Të punohet me shkollat për të përmirësuar mënyrën se si prindërit dhe familjet ftohen të marrin pjesë në punën tonë të edukimit dhe të formimit.
7. Të shtyhen shkollat që të reflektojnë mbi natyrën e shkëlqyeshmërisë gjithëpërfshirëse njerëzore (4C-të) në mënyrë që arritjet shkollore të kuptohen në kontekstin e tyre të duhur. Delegatët të angazhohen t’i shtyjnë shkollat që të reflektojnë mbi nocionet tradicionale të suksesit dhe të dështimit në jetën e nxënësve tanë.

9. <https://www.educatemagis.org/jesedu-rio2017/>

(59) **C. Të kujdesimi për Shtëpinë tonë të përbashkët: pajtim me Hyjin, njerëzimin dhe krijimin:**

8. Të nxitet një politikë mjedisore dhe sociale për secilën nga shkollat tona dhe të propozohen mënyra me të cilat rrjetet rajonale të integrojnë qartë drejtësinë, fenë dhe kujdesin për mjedisin në brendësi të kurrikulave (p.sh. teksti i Healing Earth-it: <http://healingearth.ijep.net>), duke vënë në dukje të menduarit kritik, ndërgjegjen politike dhe sociale, angazhimin - të gjitha të pasqyrohen në klasa dhe në praktikatat shkollore.
9. Të sigurohet që shkollat të kenë një program që u mundëson nxënësve që vijnë nga sektorët e përjashtuar dhe të varfër të shoqërisë të marrin pjesë në një arsimim cilësor dhe të sigurohet që shkollat që u shërbejnë konteksteve të përjashtuara dhe të varfra të arrijnë, përtej përvojave të tyre, në ndërtimin e urave me njerëz dhe bashkësi të tjera.

(60) **D. Të dërguar në një rrjet global:**

10. Gjatë vizitave dhe supervizimeve të shkollave, të vlerësohet dhe të zhvillohet niveli ekzistues i bashkëpunimit të rrjeteve rajonale dhe globale.
11. Të përfshihet në programet e formimit për mësuesit dhe stafin e ri një kuptim i faktit që mësuesit dhe stafi bashkohen me një rrjet global dhe që kanë një rol në gjallërimin e tij.
12. Të punohet me leadership-in e shkollave për t'i nxitur të gjithë mësuesit dhe stafin që të formohen në qytetarinë globale, në mënyrë që t'i ndihmojnë nxënësit ta kuptojnë të ardhmen e tyre si qytetarë globalë.
13. Educate Magis të bëhet një mjet dhe një burim tërësor në shkollat tona, me qëllim që të ndihmojnë gjallërimin dhe dimensionin e tyre global.

Ushtrimi 4. Për shoshitjen:

- a. A i njeh këto dokumente? Çfarë të prek në mënyrë të veçantë, prej tyre?
- b. Çfarë të frymëzon?
- c. Në çfarë mënyre institucioni yt apo rrjeti edukativ është duke iu përgjigjur Action statement-it të Rios? Çfarë veprimesh janë duke u vënë në veprim? Si?

Pjesa e Dytë: Realiteti i ri i botës



- (61) **Shumëçka ka ndryshuar në tri dekadat që kanë kaluar nga botimi i dy dokumenteve të para bazë të sipërpërmendura. Ndërsa reflektojmë për të kaluarën, është e rëndësishme që të respektojmë një parim themelor të edukimit të Jezuitëve të përshkruar në Pedagogjinë Injacione: të nxënit fillon me një reflektim të kujdesshëm të kontekstit.**¹⁰



1. Realiteti socio-politik

Popullsia¹¹

- (62) Popullsia njerëzore është rritur dukshëm, nga më pak se 5 miliardë në vitin 1986 në më shumë se 7 miliardë e gjysmë në vitin 2018.
- (63) Shpërndarja e popullsisë gjithashtu ka pësuar ndryshime të konsiderueshme:
- I. Nga zonat rurale në qendrat urbane.
 - II. Nga kombe më të zhvilluara në vende më pak të zhvilluara.
 - III. Nga Amerika e Veriut dhe Evropa në Afrikë, Azi dhe Amerikë Latine.¹²
- (64) Ka pasur, dhe do të vazhdojë të ketë, një plakje të popullsisë me përjashtim të Amerikës Latine dhe të Afrikës Sub-Sahariane, ku numri i të rinjve do të vazhdojë të rritet.¹³

Ushtrimi 5. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

10. <https://unric.org/it/agenda-2030/>

11. <https://www.census.gov/newsroom/stories/2018/world-population.html>

12. <https://www.un.org/development/desa/en/categories/population>

13. http://www.un.org/en/development/desa/population/publications/pdf/ageing/WPA2015_Report.pdf

Ekonomia¹⁴

- (65) Në mbarë botën përqindjet e varfërisë ekstreme kanë rënë me më shumë se gjysma që nga viti 1990.
- (66) Megjithatë, vazhdon të ketë pabarazi të konsiderueshme dhe në rritje në shpërndarjen e burimeve midis kombeve.
- (67) Brenda shumë kombeve, ka pasur një ndryshim të madh në shpërndarjen e të ardhurave dhe të burimeve ndaj klasave më të larta ekonomike, duke zgjeruar hendekun si për klasën e mesme, ashtu edhe për të varfrit.
- (68) Ekonomitë kombëtare kanë arritur nivele të reja ndërvarësie, që vënë në provë rolin e agjencive qeveritare dhe fuqinë e korporatave shumëkombëshe.

Ushtrimi 6. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

14. <http://www.worldbank.org/en/understanding-poverty>

Migrimi¹⁵

(69) Për shkak të dhunës dhe të privimit ekonomik, migrimi është rritur në mënyrë të vazhdueshme në shekullin XXI.

(70) Në fund të vitit 2017, një person ndër shtatë të tillë ishte migrant:

3,2% e popullsisë botërore përbëhej nga migrantë ndërkombëtarë (232 milionë persona).

10% e popullsisë botërore përbëhej nga migrantë të brendshëm (740 milionë persona).

Ushtrimi 7. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

15. https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/publications/migrationreport/docs/MigrationReport2017_Highlights.pdf

Mostoleranca e dhunshme¹⁶

(71) Kanë kaluar më shumë se dy dekada që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, por një formë e re konflikti global është shfaqur, që rrjedh nga e ashtuquajtura “përplasje e qytetërimeve”. Si rezultat, kemi parë dhunë të përhapur, ndonjëherë të nxitur dhe të drejtuar kah:

- I. grupet etnike;
- II. grupet fetare;
- III. bashkësitë shekullare.

Ushtrimi 8. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

16. <https://www.un.org/pga/70/wp-content/uploads/sites/10/2016/01/Conflict-and-violence-in-the-21st-century-Current-trends-as-observed-in-empirical-research-and-statistics-Mr.-Alexandre-Marc-Chief-Specialist-Fragility-Conflict-and-Violence-World-Bank-Group.pdf>

Mjedisi¹⁷

- (72) Kemi humbur sasi të mëdha tokash të pyllëzuara prej shfrytëzimit për shkak të mungesës së planifikimit strategjik dhe mbrojtjes së mjedisit.
- (73) Shumë lloje jete në tokë dhe në oqean janë në rrezik zhdukjeje për shkak të veprimtarisë njerëzore.
- (74) Të gjithë vuajnë nga efektet e ndotjes, por të varfrit janë më të prekur nga mjediset toksike.
- (75) Megjithatë, kemi parë një vetëdije më të madhe për nevojën për t'u kujdesur për planetin dhe format e jetës jo-njerëzore.
- (76) Në vitin 2015, përfaqësues nga 195 vende u mbledhën në Paris për të nënshkruar marrëveshjen e parë ligjërisht të detyrueshme për të kapërcyer ngrohjen globale për shkaqe të shpërndarjes dhe të veprimtarisë së njeriut.

Ushtrimi 8. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

17. <https://www.unenvironment.org/annualreport/2017/index.php?page=0&lang=en>

Barazia gjinore¹⁸

- (77) Në shumë pjesë të botës, roli i gruas ka ndryshuar rrënjësisht në jetën profesionale dhe atë familjare.
- (78) Përparimet gjatë tri dekadave të fundit janë të dukshme në të gjitha rajonet, por bëhet fjalë për një përparim të ngadaltë.
- (79) Në shumicën e shoqërive në mbarë botën, gratë zënë vetëm një pakicë të pozicioneve vendimmarrëse.

Ushtrimi 10. Për shohitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

18. <https://www.un.org/sustainabledevelopment/gender-equality/>

Struktura familjare¹⁹

- (80) Në një numër vendesh, gjithnjë e më pak njerëz martohen, dhe kur martohen, një përqindje e konsiderueshme në fund divorcohen, me shumë raste të njerëzve që rimartohen.
- (81) Mënyra se si e përkufizojmë një familje është duke u bërë gjithnjë e më e larmishme:
I. Familjet me një prind dhe familjet “e përziera” janë në rritje.
II. Familjet ku prindërit janë të të njëjtit seks janë në rritje.
- (82) Shumë burra marrin një rol më qendror në kujdesin ndaj fëmijëve.
- (83) Një numër i konsiderueshëm vendesh kanë parë një ndryshim të dukshëm të zakoneve shoqërore në tërheqjen për të njëjtit seks dhe në ‘paqëndrueshmërinë/ndryshueshmërinë gjinore’. Shumë nga studentët tanë tani jetojnë në një kontekst ku kjo diskutohet hapur dhe pranohet nga shumë persona.
- (84) Në vitin 1986 martesat mes personave të të njëjtit seks do të kishte qenë e paimagjinueshme. Në vitin 2015, njëzet e dy vende e legalizuan këtë praktikë.²⁰ Kisha katolike nuk i kremton dhe as nuk i njeh bashkimet e të njëjtit seks, megjithatë shumë të rinj në shkollat tona do t’i mbështesnin këto bashkime.

Ushtrimi 11. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- Si i vlerëson këto ndryshime?
- Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- Çfarë duhet të bëjë më shumë?

19. <http://www.un.org/en/development/desa/population/theme/marriage-unions/index.shtml>

20. <http://www.pewforum.org/2017/08/08/gay-marriage-around-the-world-2013>

Komunikimi

- (85) Teknologjia ka revolucionarizuar nocionet tradicionale të kohës dhe të hapësirës dhe ka ofruar mundësi të paparashikuara deri tani për komunikim, të nxënë dhe përshtirëti.²¹
- (86) Sot telefonat celularë mund të dërgojnë mesazhe me tekst, email, të ngarkojnë video dhe imazhe dhe të shkarkojnë aplikacione pothuajse për çdo gjë. Rrjetet sociale dhe blogjet mundësojnë komunikimin me persona që ndodhen larg njëri-tjetrit. Njerëzit mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në lëvizje, në çast dhe në një mënyrë gjithnjë e më të personalizuar.
- (87) Gatishmëria dhe përhapja e pajisjeve personale “smart” ka pasoja të mëdha në edukim.

Ushtrimi 12. Për shohitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

21. <https://www.media.mit.edu/about/history/>



2. Edukimi

Gatishmëria²²

- (88) Gjatë 30 viteve të fundit janë bërë përparime të rëndësishme në arsim. Numri i fëmijëve dhe i adoleshentëve që nuk kanë vijuar shkollën është përgjysmuar që nga viti 2000 deri më sot.
- (89) Përparimet më të mëdha janë arritur në barazinë gjinore.
- (90) Megjithatë, në nivel global ka ende 58 milionë fëmijë jashtë shkollës dhe rreth 100 milionë fëmijë që nuk e përfundojnë arsimin fillor.
- (91) Pabarazia për t'u arsimuar është rritur, me më të varfrit dhe më të pafavorizuarit të detyruar të mbajnë mbi supë barrat më të rënda për t'u edukuar. Në shumë vende "hendeku" midis të pasurve dhe të varfërve po zgjerohet për sa u përket rezultateve akademike dhe mundësive të studimit.
- (92) Prania e konflikteve në botë mbetet një pengesë e vështirë për t'u kapërcyer, me një përqindje të lartë dhe në rritje të fëmijëve të paarsimuar në zonat e luftës.

Ushtrimi 13. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

22. <https://en.unesco.org/gem-report/allreports>

Teknologjia²³

- (93) Në shumë pjesë të botës, kemi parë tashmë ndryshime të jashtëzakonshme në shkollat tona. Nxënësit kanë akses në informacion pa u larguar nga klasat e tyre. Mund ta marrin, ta zgjedhin, ta përpunojnë ose ta shohin informacionin.
- (94) Nëpërmjet përdorimit të Internetit ata mund të kenë akses në burimet globale për të kryer kërkime me më lehtësi, sesa do të bënin me libra dhe burime të shtypura në letër. Nxënësit janë më të interesuar, të fokusuar dhe entuziastë në lëndët që studiojnë.
- (95) Nxënësit janë më në gjendje të arsimohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të personalizuar, si dhe të mësojnë me një ritëm të përshtatshëm për zhvillimin e tyre. Me metoda të tilla si “flipped classrom”-i, aksesit në materialet mësimore në rrjet dhe modele arsimimi “blended” ose “online”, tani janë alternativa stimuluese dhe interesante në krahasim me modelet e të mësuarit “ballë për ballë”, që shkollat e Jezuitëve historikisht kanë përdorur dhe që edhe sot zhvillohen në shumicën e shkollave të tyre.
- (96) Përparimet teknologjike paraqesin gjithashtu disa sfida të rëndësishme për edukatorët. Së bashku me rrezikun e një “digital divide”-i që favorizon të pasurit ndaj të varfërve, teknologjia mund të bëhet pengesë për misionin e shkollave të Jezuitëve për të luftuar sipërfaqësoren. Në vitin 2010, Atë Adolfo Nicolás-i deklaroi:
- (97) **“Kur kaq shumë informacion mund të arrihet kaq shpejt dhe pa lodhje... puna e mundimshme dhe e kujdesshme e të menduarit serioz dhe kritik shpesh përfundon në qark të shkurtër”. E njëjta gjë vlen, vëren Atë Nicolás-i, kur bëhet fjalë për takimet njerëzore të ndërmjetësuar nga teknologjia. Marrëdhëniet rrezikojnë të bëhen sipërfaqësore kur u ikin ndërveprimeve autentike njerëzore, nga “puna e lodhshme e takimit ose, nëse është e nevojshme, e ballafaqimit dhe rrjedhimisht e pajtimit...”²⁴**

Ushtrimi 14. Për shohitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- Si i vlerëson këto ndryshime?
- Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- Çfarë duhet të bëjë më shumë?

23. <https://www.worldbank.org/en/topic/edutech>

24. http://www.sjweb.info/documents/ansj/100423_Mexico%20City_Higher%20Education%20Today_ENG.pdf

Vlera e marrjes së një edukimi

- (98) Tridhjetë vitet e fundit kemi parë një sërë zhvillimesh në vlerën e marrjes së një edukimi.

Një e drejtë themelore njerëzore

- (99) Nga ana pozitive, kemi një njohje globale në rritje të edukimit si një e drejtë themelore e njeriut.²⁵
- (100) Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) ka ripërsëritur se një vizion humanist dhe holistik i edukimit është një e drejtë themelore dhe thelbësore e njeriut për zhvillimin personal dhe socio-ekonomik.
- (101) UNESCO-ja thekson se përveç përvetësimit të njohurive bazë dhe aftësive njohëse, përmbajtjet mësimore duhet të nxisin:
- I. “problem solving”-un dhe të menduarit krijues;
 - II. kuptimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut;
 - III. përkushtimin dhe barazisë;
 - IV. larmishmërinë kulturore;
 - V. dëshirën dhe aftësinë për një edukim të vazhdueshëm dhe të nxëniet e të jetuarit së bashku.
- (102) Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, shumë përpjekje në mbarë botën kanë arritur një përparim të konsiderueshëm në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara: rritja e pjesëmarrjes në arsim, sigurimi i barazisë në shkuarjen në shkollë dhe shndërrimi i strukturave sociale të krijuara për të nxitur dinjitetin njerëzor.

25. <https://en.unesco.org/themes/right-to-education>

Një “mall” i pranishëm në treg

- (103) Megjithatë, duhet theksuar se shumë shkolla janë ndikuar nga reformat e orientuara kah tregu, të cilat mund ta reduktojnë pasurinë dhe dinjitetin e rrugëtimit edukativ thjesht në një vlerësim me pikëzim apo në një certifikim të standardizuar.
- (104) Kjo klimë “konkurruese” inkurajon forma të ekzagjeruara individualizmi, që nuk shpërblejnë procesin e rritjes së nxënësit, por thjesht i vënë ata në konkurrencë me njëri-tjetrin.
- (105) Prindërit bëhen konsumatorë dhe shqetësimet e marketingut zotërojnë mbi vlerat thelbësore.
- (106) Është e kushtueshme të konkurrosh në mënyrë të efektshme në këtë lloj tregu; shpenzimet operative shtohen, tarifat e shkollave rriten dhe si rrjedhojë mundësia për të shkuar në shkollë ulet.

Ushtrimi 15. Për shohitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?



3. Ndryshime në praktikën fetare

- (107) Gjatë tri dekadave të fundit kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në rolin e besimit fetar në shoqëri. Evropa Perëndimore dhe Amerika e Veriut, ku ndodhen një numër i mirë shkollash të Jezuitëve, kanë parë një rënie të ndjeshme të numrit të personave që pohojnë përkatësinë e tyre fetare, veçanërisht mes brezave të rinj.²⁶
- (108) Në këto vende nuk është e pazakontë të dëgjosh dyshime mbi rëndësinë e besimit fetar, veçanërisht në dritën e përparimit shkencor dhe të presioneve të kulturës konsumatore.
- (109) Ndërsa fenomeni mbetet i diskutueshëm, shprehja “shpirtërore, por jo fetare” ka hyrë në gjuhën e përbashkët dhe shumë pyesin pse të rinjtë e sotëm tërhiqen nga kjo formë e shprehjes fetare. Për të kuptuar kontekstin, ia vlen të reflektohet mbi një deklaratë në *Preferencat Apostolike Universale*:
- (110) **Në shoqërinë e pjekur të shekullarizuar krijohen hapësira për dimensionet komplekse të lirisë njerëzore, sidomos të asaj fetare.**²⁷
- (111) **Kombet më të pasura priren të jenë më pak fetare.**²⁸
- (112) **Në pjesë të tjera të botës, numri i personave që i përkasin një besimi fetar është duke u rritur.**²⁹
- (113) **Gjatë gjysmës së shekullit XXI.**³⁰
- (114) **a. përqindja e të krishterëve sipas gjasave do të jetë po ajo;**
- (115) **b. parashikohet që përqindja e myslimanëve të shtohet në mënyrë drastike, duke arritur gati numrin e të krishterëve. Po ashtu, ka mundësi që popullatat myslimane të shtohen në mënyrë të konsiderueshme në Evropën perëndimore dhe në Amerikën e Veriut.**
- (116) **c. Konfesionet e krishtera pentekostale janë në shtim në Amerikën Latine dhe në Afrikë.**

Ushtrimi 16. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

26. <http://www.pewforum.org/2018/05/29/being-christian-in-western-europe/>

27. <https://jesuits.global/it/riguardoa-noi/preferenze-apostoliche-universali>

28. <http://www.pewforum.org/religious-landscape-study/>

29. <http://www.pewforum.org/2017/04/05/the-changing-global-religious-landscape/>

30. <http://www.pewforum.org/2017/04/05/the-changing-global-religious-landscape/>



4. Ndryshime në Kishën katolike

Demografia³¹

- (117) Numri i katolikëve në botë është rritur me 57% që nga viti 1980 (popullsia e botës në të njëjtën periudhë është rritur me 47%).
- (118) Rritja sipas rajoneve:
- | | |
|---------|------|
| Afrikë | 238% |
| Azi | 115% |
| Oqeani | 67% |
| Amerikë | 57% |
| Evropë | 6% |
- (119) Në të njëjtën kohë, ka pasur largime të konsiderueshme nga Kisha katolike në favor të grupeve të tjera fetare. Për shembull, gati një në pesë latino-amerikanë identifikohen si protestantë/ungjillorë, shumë prej të cilëve janë të lidhur me një bashkësi pentekostale.
- (120) Brenda kësaj tabloje të përgjithshme të rritjes, është e rëndësishme të theksohet se numri i katolikëve që marrin sakramentet është ulur, veçanërisht në Evropë, Amerikën e Veriut, Oqeani dhe pjesë të Azisë së Paqësorit.
- (121) **Leadership-i i Kishës**
- (122) Njëzet e shtatë vitet e pontifikatit të Papa Gjon Palit II u shënuan nga:
- ndryshime drastike politike, me përfundimin e regjimeve komuniste në Evropë;
 - centralizimi i autoritetit në Romë, i papërjetuar më përpara;
 - përdorimi i efektshëm i udhëtimeve në mbarë botën dhe i mas mediave.
- (123) Papa Benedikti XVI, edhe pse i ndryshëm në temperament, çoi përpara shumë nga politikat dhe përparësitë e paraardhësit të tij. Në shkurt 2013, Papa Benedikti dha dorëheqjen nga papati, gjë që nuk kishte ndodhur prej gjashtëqind vjetësh.

31. <http://www.pewforum.org/2013/02/13/the-global-catholic-population/>

- (124) Papa Françesku, papa i parë jezuit, është zgjedhur në mars 2013. Ai është angazhuar në këto lëme vepruese:
- I. Reforma e Kuries Romake dhe decentralizimi i konsiderueshëm i procesit të vendimmarrjes.
 - II. Dialogu ekumenik dhe ndërjetar.
 - III. Kontributi në qëndrueshmërinë mjedisore.
 - IV. Mbrojtja e të varfërve dhe e emigrantëve.

Kongresi botëror:

“Të edukosh sot e nesër. Një pasion që ripërtërihet”³²

- (125) Kuvendi i vitit 2015 pohoi se edukimi katolik duhet:
- I. ta edukojë krejt personin; të kujdeset për formimin, jo vetëm për informimin;
 - II. të jetë i respektueshëm dhe i hapur ndaj të tjerëve, në një botë multikulturore dhe multifetare;
 - III. të krijojë një bashkësi mikpritëse për të rinjtë dhe familjet;
 - IV. të jetë i arritshëm prej të gjithëve, sidomos prej familjeve me pak burime financiare;
 - V. të fokusohet mbi transhendenten: misterin dhe mrekullinë e Hyjit.

Ushtrimi 17. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

32. <http://www.educatio.va/content/cec/it/eventi/congresso-educare-oggi-e-domani/congresso-educare.html>



5. Ndryshime në Shoqërinë e Jezusit

Demografia³³

- (126) Në vitin 1986 ishin më shumë se 25.000 Jezuitë në gjithë botën.
- (127) Në vitin 2015 Jezuitët ishin 16.740, me një rënie prej 33%.
- (128) Gjeografikisht, numri i Jezuitëve në Afrikë u rrit gjatë kësaj periudhe 30-vjeçare; tregoi një rritje të lehtë në Azinë Jugore; një rënie të lehtë në Azinë Lindore, një rënie prej 35% në Amerikën Latine dhe një rënie gati 50% në Evropë dhe në Amerikën e Veriut.
- (129) Plakja: në 30 vitet e fundit kemi qenë dëshmitarë të plakjes së Jezuitëve për shkak të jetëgjatësisë më të madhe dhe numrit më të vogël të të rinjve që hyjnë, veçanërisht në Evropë dhe në Amerikën e Veriut. Mosha mesatare ndryshon në mënyrë të konsiderueshme dhe pasqyron zhvendosjen demografike drejt Afrikës dhe Azisë Jugore.

Leadership-i i Shoqërisë

- (130) Ka pasur tri Kongregata të Përgjithshme këto 30 vitet e fundit.
- (131) Kongregata e Përgjithshme XXXIV (1995) ripohoi temat kryesore të Kongregatave të Përgjithshme XXXII dhe XXXIII. Jezuitët dhe ata që punojnë me ta janë thirrur të përqafojnë thirrjen e Krishtit:
 - I. për të plotësuar nevojat e të varfërve dhe të të përjashtuarve;
 - II. për t'i respektuar dhe për t'i mikpritur personat e kulturave dhe të traditave të ndryshme fetare;
 - III. për t'i parë laikët si bashkëpunëtorë me meritë dhe dinjitet të barabartë;
 - IV. për të mësuar nga përvoja e grave që shpesh kanë qenë të mënjanuara nga Kisha dhe shoqëria.
- (132) Dekreti 18 ka të bëjë me edukimin para-universitar dhe jointitucional, duke nënvizuar:
 - I. rolin qendror të laikëve si edukatorë në traditën injaciane;
 - II. përpjekjet për t'i bërë shkollat e Jezuitëve të arritshme prej të rinjve që vijnë nga familje me burime të pakta financiare;
 - III. shkollat si platforma që prekin jo vetëm bashkësinë e madhe të prindërve, të ish-nxënësve dhe të miqve, por edhe të varfrit dhe të pafavorizuarit socialë të zonës;
 - IV. rëndësinë e kopshteve të mbarështuara ose të mbështetura nga Shoqëria.

33 https://cara.georgetown.edu/wp-content/uploads/2018/06/Men_Religious_Fall2015_FINAL.pdf


- (133) Kongregata e Përgjithshme XXXV (2008) njohu ritmin në rritje të ndryshimit në botën postmoderne.
- I. Ka vënë në dukje çështje të teknologjisë, të vetëdijes mjedisore, të migrimit dhe të globalizimit.
 - II. Ka ripohuar thirrjen e Krishtit në shërbim të fesë dhe të nxitjes së drejtësisë.
 - III. Ka njohur qendërsinë e bashkëpunëtorëve dhe ka theksuar rëndësinë e formimit të tyre në karizmën injaciane, duke e parë thirrjen e Jezuitëve si një zjarr që ndez zjarre të tjera.
 - IV. Në dritën e numrit në rënie të Jezuitëve, ka ngritur një pyetje themelore në lidhje me identitetin institucional: me pak ose aspak Jezuitë të pranishëm, çfarë e bën "jezuite" një shkollë Jezuitësh?
 - V. Ka diskutuar për apostullimin me të rinjtë, duke thënë: "Duhet të shohim me kujdes se si t'i çojmë përpara mbarëshkrimet tona edukative dhe baritore - veçanërisht mes të rinjve - në këtë kulturë postmoderne që ndryshon me shumë shpejtësi. Duhet të ecim së bashku me të rinjtë, duke mësuar nga bujaria dhe dhembshuria e tyre, në mënyrë që ta ndihmojmë njëri-tjetrin të rritemi përmes brishtësive dhe ndarjeve, derisa të arrijmë një integrim të gëzueshëm të jetës sonë me Hyjin dhe me të tjerët" (Dekreti 3, nr. 23).
- (134) Kongregata e Përgjithshme XXXVI (2016), në Dekretin 1, ka uruar një "zgjim shpirtëror" si hapin e parë për t'i bërë ballë krizës urgjente dhe komplekse mjedisore dhe sociale të pranishme në çdo pjesë të botës; ka njohur gjithashtu ritmin në rritje të ndryshimit në botën postmoderne.
- (135) Ky dekret na thërret që të jemi shokë në një mision pajtimi dhe drejtësie.

Fjalime mbi edukimin mbajtur nga Eprorët e Përgjithshëm

- (136) Etërit Peter Hans Kolvenbach-u S.J., Adolfo Nicolás-i S.J. dhe Arturo Sosa S.J., tre Eprorët e Përgjithshëm pas botimit të Karakteristikave, kanë bërë një sërë fjalimesh mbi edukimin. Edhe pse disa janë mbi edukimin universitar, të gjitha këto fjalime përmbajnë ide të rëndësishme për çdo shkollë të Jezuitëve.
- I. Katërbëdhjetë paraqitje të Atë Kolvenbach-ut në gjuhën origjinale gjenden në adresën <http://www.sjweb.info/education/doclist.cfm#kolv>
 - II. Pesëmbëdhjetë paraqitje të Atë Nicolás-it në gjuhën origjinale gjenden në adresën <http://www.sjweb.info/education/doclist.cfm#nico>

III. Paraqitjet e Atë Sosa-s në gjuhën origjinale gjenden në adresën <http://www.sjweb.info/education/doclist.cfm>

Gurë të vonë miliarë



- (137) Në vitin 2012, i pari *International Colloquium in Jesuit Secondary Education*-i i mbajtur në Boston, SHBA, ka mbledhur së bashku edukatorë të shkollave të Jezuitëve të mbarë botës për të arritur në një vizion njësoes dhe për të kremtuar larmishmërinë e pasur të rrjetit.
- (138) Në vitin 2014, SIPEI (*Seminario Internacional de Pedagogía y Espiritualidad Ignacianas*) ka mbledhur së bashku udhëheqës dhe intelektualë të rrjetit global për të reflektuar mbi katër atributet që Atë Kolvenbach-u kishte sugjeruar që nxënësit duhet të zotëronin në fund të edukimit të marrë në shkollat e Jezuitëve. Këto attribute, të njohura edhe si "4C"-të, janë: ndërgjegjja, kompetenca, dhembshuria dhe përfshirja.

- (139) Në vitin 2015, themelimi i *Educate Magis-it*, komuniteti ndërveprues në internet i krijuar për të shërbyer si një platformë për ndërveprimet midis nxënësve dhe edukatorëve në shkollat e drejtuara nga Jezuitët në mbarë botën.
- (140) Action Statement-i i *IESEDU-Rio-s*, i vitit 2017, përfaqëson një moment vërtet të rëndësishëm shoshitjeje në procesin e veprimit “si një trup universal me një mision universal” (GC 35, Dekreti 2, nr. 20). Për një shpjegim, shihni numrat 56-60 të këtij dokumenti.
- (141) Në vitin 2018, Ati Gjeneral Arturo Sosa ka mbajtur një fjalim në Kongresin e shkollave Fe y Alegría me temën e nxitjes së të drejtës për një arsimim cilësor për të gjithë:
- (142) **“Është një imperativ moral që të bëhet presion, të kërkohet dhe të nxitet e drejta për një edukim cilësor për të gjithë. Ju inkurajoj që të vazhdoni të shpallni se cilësia është e pamundur pa shkolla gjithëpërfshirëse dhe të sigurt: shkolla që mirëpresin dhe integrojnë, shkolla që vlerësojnë larmishmërinë, shkolla që janë novatore, të ndjeshme ndaj kontekstit dhe domethënëse”.**³⁴

Shkollat e Jezuitëve³⁵

- (143) Çfarë do të thotë të jesh një shkollë “e Jezuitëve”? Një shkollë, a është e Jezuitëve falë historisë së saj, e cila është themeluar dhe drejtohet nga Jezuitët për shumë vite? Një shkollë, a është e Jezuitëve falë statusit të saj kanonik? Një shkollë, a është e Jezuitëve, sepse Jezuitët punojnë aty? A është e tillë falë historisë apo zgjedhjes? A është falë substancës apo emrit të saj? Apo është “e Jezuitëve” për arsye *marketingu* apo *marke*?
- (144) A janë “të Jezuitëve” vetëm shkollat e mbështetura dhe të ngritura kanonikisht nga Shoqëria e Jezusit?
- (145) Nëse po, ata edukojnë rreth 800.000 nxënës në mbi 850 shkolla dhe vetëm 4.3% e stafit janë Jezuitë. (Në Amerikën e Veriut dhe Evropë, kjo përqindje pritet të ulet në vitet e ardhshme).

34 http://www.sjweb.info/documents/assj/20180929_SOSA_Arturo_47_FyA_International_Congress.pdf

35 <https://www.educatemagis.org/blogs/secretariat-of-education-publishes-statistic-report-for-2018/>

- (146) A janë shkolla “të Jezuitëve” ato që bazohen mbi çfarëdo forme lidhjeje me Shoqërinë e Jezusit?
- (147) Nëse po, këto shkolla edukojnë mbi 2 milionë nxënës në afro 2.300 shkolla; Jezuitët përbëjnë vetëm 2% të stafit.

Shkolla dhe rrjete të reja

- (148) Gjatë 30 viteve të fundit kemi parë lindjen e shkollave të reja të Jezuitëve dhe të rrjeteve shkollore, që janë të arritshme prej personave me burime modeste ose të pakta financiare.
- a) *Nativity Schools*-et ofrojnë edukim falas dhe krijues për fëmijët para-adoleshentë.
 - b) *Cristo Rey Schools*-et ofrojnë edukim universitar për djemtë dhe vajzat nëpërmjet një programi krijues ku alternohet shkolla me punën.
 - c) Në Amerikën Latine, tani edhe në Afrikë, rrjeti i shkollave *Fey Alegría* vazhdon rritjen e tij të konsiderueshme duke ofruar mundësi edukimi në sektorët më të varfër të shoqërisë.

Në 51 vende të botës, *Jesuit Refugee Service*-i i ka ofruar edukim, ndihmë emergjente dhe shërbime shëndetësore më shumë se 700.000 personave.

- (149) Këto rrjete lidhen me Shoqërinë në mënyra të ndryshme, duke treguar mundësitë e pabesueshme që hapen për apostullimin tonë edukativ kur punojmë me Kongregata të tjera rregulltare, laikë dhe edukatorë që bashkëndajnë objektivat e edukimit të Jezuitëve.

Jezuitët dhe kolegët laikë

- (150) Përgjatë historisë së tyre 450-vjeçare, shkollat e Jezuitëve janë mbështetur në bashkëpunimin dinamik midis Jezuitëve dhe kolegëve laikë. Sot një pjesë e madhe e përgjegjësisë së misionit të shkollave tona u takon laikëve. Burrat dhe gratë me përkatësi katolike bashkohen me ata që kanë tradita të tjera të krishtera për të formuar “burra dhe gra për të tjerët”. Ashtu si edhe për nxënësit tanë, shkollat tona përjetojnë pasurinë që vjen nga prania e mësuesve, e stafit jomësimdhënës dhe atij administrativ me tradita të tjera fetare; në disa vende, këta njerëz përbëjnë shumicën dërrmuese.

Kjo ka qenë një dhuratë e madhe: zgjerimi në mënyrë krijuese i të kuptuarit tonë të përshpirtërisë dhe të identitetit inxhian.


Ushtrimi 18. Për shoshitjen:

Në rajonin tënd të botës:

- a. Si i vlerëson këto ndryshime?
- b. Cilat mendon se janë linjat më të rëndësishme të zhvillimit?
- c. Cilat prej tyre të duken se pasqyrojnë të mirën më të madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Si i jemi përgjigjur Action Statement-it të JESEDU të Rios së vitit 2017?
- f. Çfarë mund të bëjmë tjetër për t’iu përgjigjur më mirë këtij Action Statement-i?
- g. Çfarë duhet të bëjë apostullimi yt edukativ?

Pjesa e Tretë:

Elemente identifikuese globale të shkollave të Jezuitëve



Të veprohet si një trup universal me një mision universal³⁶

- (152) Në *Parimin dhe Themelimin* e Ushtrimeve Shpirtërore, Injaci shkruan se të gjitha gjërat e krijuara ekzistojnë për të njëjtën arsye: për lavdinë më të madhe të Hyjit dhe për shpëtimin e shpirtave (U.S.H., nr. 23). Çdo gjë tjetër është dytësore dhe, si rrjedhojë, kalimtare. Gjërat e krijuara duhen përqafular për atë që i shërbejnë qëllimit dhe duhen shmangur për atë që na largojnë nga qëllimi. Rezultati është një liri shpirtërore, të cilën Injaci do ta quante një “indiferencë” e shëndetshme, e cila i lejon njerëzit të marrin vendime në dritën e qëllimit përfundimtar. Kjo perspektivë teleologjike ofron një logjikë për të kërkuar shenja të reja të kohës dhe për ta parë ndryshimin si diçka që duhet shoshitur dhe përqafular, por jo për t’u pasur frikë.
- (153) Mund të mos jetë i lehtë pranimit i sfidës së ndryshimit, por duke pasur parasysh entitetin e ndryshimit në kulturë, arsim, fe, katolicizëm dhe në Shoqërinë e Jezusit gjatë tridhjetë viteve të fundit, nuk ka zgjidhje tjetër. Ekziston tundimi për t’u mbështetur në një të kaluar tashmë të eksperimentuar. Shkollat e Jezuitëve duhet të jenë diçka më shumë se “më e mira e traditës”, siç thonë disa; ata nuk janë muzeume ku ka ngrirë një karizmë e gjallë. Në një fjalim në fund të Vitit të Jetës së Kushtuar, Papa Françesku u ka folur anëtarëve të Urdhrave rregulltarë me fjalë që mund të vlejnë për të gjithë ne, Jezuitë dhe anëtarë laikë të apostullimit tonë edukativ:
- (154) **“Edhe ne, si të krishterë dhe si persona të kushtuar, jemi kujdestarë të mrekullimit. Një mrekullim që kërkon gjithmonë të ripërtërihet; mjerë ne nëse diçka na bëhet zakon në jetën shpirtërore; mjerë ne nëse i kristalizojmë karizmat tona në një doktrinë abstrakte: karizmat e themeluesve - siç e kam thënë edhe në raste të tjera - nuk duhet të mbyllën në shishe, nuk janë objekte muzeale. Themeluesit tanë e kanë lënë veten të shtyhen nga Shpirti Shenjt dhe nuk kanë pasur frikë t’i ndotnin duart me jetën e përditshme, me problemet e njerëzve, duke përshkuar me guxim periferitë gjeografike dhe ato ekzistenciale. Nuk janë ndalur përpara pengesave dhe moskuptimeve të të tjerëve, pasi kanë ruajtur në zemër mrekullimin për takimin me Krishtin. Nuk e kanë zbutur hirin e Ungjillit; kanë pasur gjithmonë në zemrën e tyre një shqetësim të shëndetshëm për Zotin, një dëshirë të zjarrtë për t’ua çuar Atë të tjerëve, siç kanë bërë Maria dhe Jozefi në tempull. Edhe ne sot jemi të thirrur që të bëjmë zgjedhje profetike dhe të guximshme”.**

36. http://www.sjweb.info/education/doc-neës/JESEDU-Rio%202017_Action_Statement_EN_Final_171121.pdf

- (155) Të shtyrë nga shpirti i Ushtrimeve Shpirtërore, të gjithë ne, në të gjitha shkollat tona jezuite, duhet të përqafojmë një ndjenjë mrekullimi dhe shprese, ta vlerësojmë traditën, t'i shohim nevojat e botës dhe të përgatitemi për të eksperimentuar mënyra të reja, me qëllim që t'i arrijmë qëllimet tradicionale: lavdinë më të madhe të Hyjit dhe shpëtimin e shpirtit.³⁷
- (156) Në këtë ushtrim, kemi rishqyrtuar disa nga dokumentet tona bazë dhe kemi reflektuar mbi realitetin aktual të botës. Duke u nisur nga ajo që është përvetësuar, në këtë seksion do të propozojmë disa elemente identifikuese globale të vlefshme për të gjitha shkollat tona jezuite.
- (157) Le t'i shohim këta "identifikues" si angazhime që çdo shkollë jezuite mund të marrë. Ato mbështeten në burimet e pranishme të *Karakteristikave të edukimit të Jezuitëve* dhe të *Preferencave Apostolike Universale*, dhe i referohen realitetit aktual të botës.

37. <https://jesuits.global/it/uap/ildiscernimento-e-gli-esercizi-spirituali>



- (158) Edhe pse nivelet e bashkëngjitjes ndaj besimit fetar ndryshojnë në mbarë botën, shumë nxënës janë duke u rritur në një botë gjithnjë e më “pas-institucionale”, gjë që vihet re në pakënaqësinë ndaj organizatave tradicionale fetare dhe në një jetë gjithnjë në rritje “të privatizuar”, gjë që kufizon kuptimin e tyre të së mirës së përbashkët.
- (159) Kjo gjë është veçanërisht shqetësuese kur flasim për shkollën si një trup apostolik në Kishë. Për shumë nxënës dhe familje, lidhja e brendshme ndërmjet kumtimit të Ungjillit dhe objektivave didaktike-edukative të shkollave tona nuk është më aq e dukshme.
- (160) Ajo që është më shqetësuese është fakti se një përqindje e madhe e mësuesve tanë identifikohen më lehtë me një shkollë që e quan veten e Jezuitëve, sesa me një shkollë që e quan veten “katolike”.
- (161) Shembulli i Papa Françeskut për një jetë të krishterë të karakterizuar nga gëzimi po i jep frymëmarrje të re këtij reflektimi. Gjatë takimit me nxënësit e shkollave të Jezuitëve nga Italia dhe Shqipëria, Ati i Shenjtë theksoi rëndësinë e bërjes së pyetjeve rreth bindjeve dhe dyshimeve vetjake mbi fenë, si anëtarë të Kishës shtegtare në tokë. “Ecja në rrugën e fesë”, u kujtoi Papa nxënësve tanë, “ka të bëjë me artin e të shikuarit të horizontit [...] Ecja në bashkësi, me miqtë, me ata që na duan: kjo na ndihmon për të arritur atë qëllim që duhet të arrijmë”.
- (162) Thirrja për të edukuar nga zemra e Kishës është veçanërisht e rëndësishme kur mendojmë për strukturën e ardhshme të shkollave tona. Shumë është bërë për ta zgjidhur çështjen se “si do të duken shkollat tona jezuite kur të mos ketë më Jezuitë”. Një pyetje më e vështirë është: “Si do ta sigurojmë katolicitetin e shkollave tona në të ardhmen?”.

38. <https://jesuits.global/it/uap/ildiscernimento-e-gli-esercizi-spirituali>

- (163) Një kërkim i kohëve të fundit bërë pranë Universitetit të Lovanos³⁹ ofron një kornizë të dobishme referimi për të eksploruar identitetin katolik të shkollës së Jezuitëve sot. Në këtë skemë identifikohen katër lloje shkollash:
- (164) **“Shkolla e monologut”, e cila ka një identitet të fortë të krishterë, përballë një ndërveprimi minimal me botëkuptime të tjera të botës;**
- (165) **“shkolla pa ngjyrë”, e cila vepron në një sferë neutrale ku personat janë të lirë ta zgjedhin filozofinë e tyre të jetës, të izoluar nga të tjerët. Ajo ndjek parimin “jeto dhe lër të jetojnë”, me një ndjenjë të ulët bashkësie dhe pak të mbështetur nga njëri-tjetri;**
- (166) **“shkolla e njëmijë ngjyrave”, ku ka një mbështetje të fortë të pluralitetit, por ku feja katolike zëvendësohet prej një shumëllojshmërie vizionesh të botës dhe filozofish, njëra prej të cilave është krishterimi;**
- (167) **“shkolla e dialogut”, e cila është lloji i preferuar i shkollës katolike për kontekstin tonë aktual; një shkollë që zgjedh ta jetojë shprehimisht frymëzimin e traditës së saj të krishterë, duke pranuar në të njëjtën kohë praninë e traditave të tjera. Në këtë shkollë ekziston një “opsion preferencial” për traditën e krishterë, që çdo herë kërkon të ri-kuptojë vlerën dhe domethënien e të qenit të krishterë në mes të një morie opsionesh të tjera. Kjo është shkolla që i ndihmon nxënësit ta pjekin fenë e tyre nëpërmjet dialogut, formimit dhe ndërveprimit. Ky është modeli i shkollës që duhet t’i frymëzojë shkollat e Jezuitëve.**
- (168) Duke përqafuar modelin e “shkollës së dialogut”, shkollat e Shoqërisë janë të thirrura që të qëndrojnë në kufi, dhe kjo duhet të përfshijë kufijtë e një Kise e cila, siç ka sugjeruar Ati i Shenjtë, është “me gunga, e plagosur dhe e pistë, sepse ka dalë rrugëve”.⁴⁰

39. https://www.kuleuven.be/thomas/cms2/uploads/file/reader/Framing_the_identity_of_Catholic_schools.pdf

40. http://www.vatican.va/content/francesco/it/apost_exhortations/documents/papa-francesco_esortazione-ap_20131124_evangelii-gaudium.html

- (169) Kështu, objektivi i vetëm i shkollave tona, siç u kujtoi Papa Françesku mësuesve të shkollave të Jezuitëve, është ai që të formojmë “persona të pjekur, të thjeshtë, kompetentë dhe të ndershëm, që dinë të duan me besnikëri, që dinë ta jetojnë jetën si përgjigje ndaj thirrjes së Hyjit dhe profesionin e ardhshëm si një shërbim ndaj shoqërisë”.⁴¹
- (170) Kjo mund të arrihet kur shkollat tona funksionojnë si modele profetike të bashkimit të krishterë brenda Kishës - shembuj mbarështimi sinqerisht të bashkëndarë mes laikëve dhe bashkëpunëtorëve Jezuitë; shembuj angazhimi të thellë ndaj të varfërve; shembuj të një teologjie pozitive të botës, të rrënjësuar thellësisht në Mishërim; shembuj të përkushtimit dhe të mikpritjes për ata që janë në kufi, duke përfshirë ata që janë në kufi të vetë Kishës.
- (171) Edukimi i Jezuitëve duhet të orientohet kah ofrimi i një formimi të shëndoshë fetar dhe i një edukimi teologjik për të gjithë anëtarët e bashkësisë së tij, si dhe kah sigurimi i një katekeze të shëndoshë për katolikët. Jo të gjithë personat e lidhur me një shkollë jezuite janë ose do të jenë katolikë, por të gjithë janë të ftuar ta kuptojnë identitetin kishtar të shkollës dhe të marrin pjesë në atë identitet në masën që është e përshtatshme për secilin. Prej momentit që edukatorët e shkollave jezuite e shikojnë në sy të ardhmen, ata duhet të mësojnë ta balancojnë veçantinë e rrënjëve të tyre institucionale me pluralizmin e besimtarëve nga tradita të tjera fetare - dhe të jo besimtarëve. Shkollat tona duhet të jenë vërtet “shkolla të dialogut”. Në këtë kuptim, shkollat e Shoqërisë janë të angazhuara edhe në një dialog ndër fetar, i cili i përgatit nxënësit tanë që të kuptojnë, të përqafojnë dhe të lidhen me larmishmërinë fetare aktuale të botës sonë.

Ushtrimi 19. Për shoshitjen:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- c. Si mund të përshtatemi për t’iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

41. http://www.vatican.va/content/francesco/it/speeches/2013/june/documents/papa-francesco_20130607_scuole-gesuiti.html

2. Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë ⁴²



- (172) Shkollat tona duhet të nxisin dhe të garantojnë mjedise të lira nga çdo formë abuzimi.⁴²
- (173) Megjithëse Papa Françesku i ka dhënë shumë jetë dhe gjallëri Kishës katolike, plagët e thella të abuzimit seksual nga anëtarët e klerit mbeten dhimbshëm reale për viktimat dhe familjet e tyre dhe, në të vërtetë, për të gjithë anëtarët e Kishës. Jeta e këtyre viktimave është shënuar përgjithmonë nga kjo tradhti. Veprimet e autorëve dhe për rrjedhojë mosveprimi apo mashtrimi nga ana e disa udhëheqësve kishtarë kanë dëmtuar rëndë besueshmërinë e Kishës. Disa shkollave tona u është dashur të përballen me këto mëkate të tmerrshme të kryera ndaj nxënësve të tyre në vetë institucionet tona.
- (174) Prandaj është thelbësore që të gjithë edukatorët dhe administratorët e shkollave të Jezuitëve të krijojnë mjedise të sigurta dhe të shëndetshme, të lira prej çdo forme abuzimi: seksual, fizik, psikologjik ose emocional, duke përfshirë marrëdhëniet e papërshtatshme me të rriturit dhe bullizmin mes bashkëmoshatarëve.
- (175) Të gjitha shkollat e Jezuitëve duhet të kenë:
- (176) **a. Udhëzime që përshkruajnë sjelljen e duhur etike dhe profesionale për secilin prej atyre që shërbejnë në shkollat tona, qofshin ata Jezuitë, punonjës apo vullnetarë.**
- (177) **b. Formim sistematik dhe programe formimi të vazhdueshëm për të gjithë anëtarët e bashkësisë shkollore, që synojnë rrënjosjen e mënyrave respektuese në marrëdhëniet me të tjerët, identifikimin e sjelljeve të papërshtatshme dhe shpjegimin se si të trajtohen personat dhe situatat e abuzimit.**
- (178) **c. Protokolle për t'iu përgjigjur menjëherë çfarëdo forme akuze abuzimi.**

Ushtrimi 20. Për shoshitjen:

- Si e vlerëson këtë sfidë?
- Cilat janë pengesat më domethënëse?
- Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- Çfarë duhet të bëjë më shumë?

42. <https://jesuits.global/it/uap/camminare-con-gli-esclusi>

3. Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në qytetarinë globale⁴³ 67



- (179) Kjo nënkupton përgatitjen e nxënësve dhe të familjeve të tyre për ta identifikuar veten para së gjithash si anëtarë të familjes njerëzore, të pajisur me një përgjegjësi të përbashkët për mbarë botën, dhe jo thjesht si anëtarë të një kombi apo grupi të caktuar.
- (180) Për pjesën më të madhe të historisë së tij, edukimi i Jezuitëve ka qenë shumëkombësh. Kemi shumë për të kontribuar në këtë përpjekje qytetarie globale. Vizioni ynë injacian na mundëson që ta gjejmë Hyjin në çdo gjë dhe ta ndezim botën me ngrohtësinë dhe dritën e dashurisë shpëtuese të Hyjit. T'i përgatitësh nxënësit e shkollave të Jezuitëve për t'u bërë qytetarë globalë do të thotë t'i përgatitësh ata që ta shohin me të vërtetë Hyjin në të gjitha gjërat, të udhëhiqen nga dhembshuria dhe ta përdorin fuqinë e fesë për drejtësi dhe paqe.
- (181) Mbi të gjitha, shkollat tona janë instrumente nëpërmjet të cilave Shoqëria e Jezusit përmbush misionin e saj të shprehur në dokumentet e Kongregatës së Përgjithshme XXXV, "Misioni ynë i fesë dhe i drejtësisë". Dialogu ndërmjet besimeve fetare dhe kulturave ka marrë përmasa të tilla, saqë nuk na lejojnë më ta konceptojmë botën si të përbërë nga entitete të ndara; duhet ta shohim si një tërësi të njëzuar në të cilën të gjithë varem nga njëri-tjetri.
- (182) Për këtë qëllim, edukimi i qytetarisë globale nuk duhet të jetë vetëm një përbërës shtesë, por duhet të integrohet në kurrikulë. Kjo ndodh kur mësuesit dhe nxënësit përfshijnë përvoja kulturore globale në shkollimin e tyre, kur mësohen aftësi komunikuese globalisht të vetëdijshme, gjithëpërfshirëse dhe të efektshme, kur të gjitha disiplinat trajtohen me një vetëdije të globalizimit dhe të ndikimit të tij në të nxënësit e shekullit XXI, dhe kur të pasurit në bagazhin personal e përvojave globale shumëkulturore vendoset si përparësi në kurrikulën didaktike të nxënësve dhe në kriteret e punësimit të mësuesve (punësimi "për misionin").
- (183) Kjo duhet të çojë në një pedagogji dhe në një programim didaktik që synon përgatitjen e nxënësve për t'i kuptuar dhe për t'i respektuar kulturat e botës, për ta respektuar dhe për ta vlerësuar larmishmërinë, për të qenë të hapur ndaj përvojave nga vende, tradita dhe kultura të ndryshme prej vendeve të tyre dhe për të pasur një perspektivë globale për padrejtësitë sociale.

43. <https://jesuits.global/it/uap/accompagnare-i-giovani>

- (184) Shkollat tona duhet të kërkojnë:
- I. kompetenca për të biseduar në gjuhë të huaja;
 - II. binjakëzime mes shkollave në mbarë botën;
 - III. programe bashkëpunimi ndërmjet shkollave për të shqyrtuar çështje globale dhe për të nisur projekte të përbashkëta.
- (185) Këto objektiva mund të arrihen nëpërmjet shëtitjeve kulturore, përvojave të shërbimit ndërkombëtar dhe mundësive për t'u zhytur në kultura të tjera, programeve të shkëmbimit me karakter akademik, shkëmbimeve teknologjike të avancuara si klasa, seminare dhe kurse "virtuale"; tërheqje shpirtërore, programe vullnetariati shumëkulturor dhe stile kremtimi liturgjik që pasqyrojnë larmishmërinë e pranishme në Kishën tonë në botë. Nxënësit që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta duhet të përfaqësohen mirë në të gjitha këto aktivitete.
- (186) Shkollat e Jezuitëve përfitojnë nga një rrjet i brendshëm i përshtatshëm për të krijuar lidhje, binjakëzime dhe marrëdhënie mes shkollave në mbarë botën. Brenda shkollave tona ka mjaftueshmërisht siguri, njohuri dhe prani të konsoliduar në territor.
- (187) Kjo do t'u kërkojë shkollave tona që të jetojnë në tensionin krijues midis të qenit të rrenjosura dhe të qenit të vetëdijshme në nivel lokal dhe global. Duam që nxënësit tanë ta njohin, ta vlerësojnë dhe ta kremtojnë bashkësinë, traditën dhe kulturën e tyre lokale dhe, në të njëjtën kohë, të jenë në gjendje të komunikojnë, të punojnë dhe të identifikohen me të tjerët si anëtarë të bashkësisë sonë globale. Ky është një element i rëndësishëm që gjendet në *community* të *Educate Magis*-t.⁴⁴ Ajo ofron një platformë web për të gjitha institucionet tona dhe edukatorët tanë, platforma ku të gjithë mund të përfshihen në një proces dinamik dhe krijues marrëdhëniesh të ndërsjella.

Ushtrimi 21. Për shoshitje:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- c. Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

44. <https://www.educatemagis.org/my-community/>

4. Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në kujdesin ndaj krijimit⁴⁵ 69



- (188) Më 24 maj 2015, Papa Françesku shpalli enciklikën *Laudato si'*, e cila kishte për qëllim nxitjen e dialogut për shtëpinë tonë të përbashkët, e cila po pëson një përkeqësim serioz për shkak të mosveprimet dhe të lakmisë njerëzore. Për Papën, kriza ekologjike është një thirrje për një kthim të thellë të brendshëm, pasi çdo njeri është i thirrur që të jetë mbrojtësi i veprës së Hyjit. Rrjedhoja për shkollat e Jezuitëve është e qartë. Në kapitullin nr. 6 Papa shkruan:⁴⁵
- (189) **“Shumë gjëra duhet ta riorientojnë drejtimin e tyre, por para së gjithash është njerëzimi ai që ka nevojë të ndryshojë. Mungon vetëdija për një origjinë të përbashkët, për një përkatësi të ndërsjellë dhe për një të ardhme të bashkëndarë nga të gjithë. Kjo vetëdije bazë do të lejonte zhvillimin e bindjeve të reja, qëndrime dhe stile jete të reja. Kështu del në pah një sfidë e madhe kulturore, shpirtërore dhe edukative që do të kërkojë procese të gjata ripërtëritjeje”**.⁴⁶
- (190) Për shkollat tona, kjo nënkupton përgatitjen e nxënësve dhe të familjeve të tyre që të identifikohen dhe të ndihen përgjegjës ndaj krejt krijimit; marrjen e vizionit dashuror të Hyjit për botën. Edhe një herë, ia vlen të reflektojmë mbi kërkesat e treguara në Preferencat Apostolike Universale:
- (191) **“Propozojmë, duke u nisur nga ajo që jemi dhe me mjetet që kemi, që të bashkëpunojmë me të tjerët për ndërtimin e modeleve alternative të jetës, bazuar në respektimin e krijimit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm, të aftë për të prodhuar mallra të cilat, të shpërndara me drejtësi, garantojnë një jetë dinjitoze për të gjitha qeniet njerëzore në planetin tonë”**.⁴⁷
- (192) Ky angazhim duhet të shfaqet në hartimin e kurrikulave të sakta shkencore, që u ofrojnë nxënësve një kuptim të mirë-informuar mbi çështje të tilla si ngrohja globale, veçanërisht kur shumë persona mohojnë se gjendja aktuale është e tillë për shkak të veprimtarisë njerëzore.

45. <https://www.jesuits.global/it/uap/prendersi-cura-della-nostra-casa-comune/>

46. http://www.vatican.va/content/francesco/it/encyclicals/documents/papa-francesco_20150524_enciclica-laudato-si.html

47. <https://jesuits.global/it/riguardo-a-noi/preferenze-apostoliche-universali>

- (193) Për këtë qëllim, edukimi mjedisor duhet të jetë pjesë e kurrikulës bërthamë. Shkollat tona duhet të përfshijnë:
- (194) 1. Një etikë ekologjike në kurset tona të shkencës, të teologjisë dhe të shkencave humane.
- (195) 2. Partneritetet mes shkollave të mbarë botës që synojnë kujdesin ndaj krijimit.
- (196) 3. Programe vullnetariati dhe presioni politik për adresimin e çështjeve të mëposhtme:
- I. ndotja e ajrit dhe e ujit;
 - II. humbja e habitatit që ka çuar në prag të zhdukjes forma të ndryshme jete.
- (197) Shkollat tona duhet të bëjnë çdo përpjekje për t'u bërë të qëndrueshme nga këndvështrimi mjedisor:
- I. duke reduktuar emetimet e tyre të dioksidit të karbonit;
 - II. duke blerë mallra që janë prodhuar në mënyrë të përgjegjshme dhe që riciklohen siç duhet apo që janë të riciklueshme.

Ushtrimi 22. Për shoshitjen:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
 - a. Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide
 - c. për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
 - d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
 - e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

5. Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në drejtësi 71



- (198) Në vitin 1974, Shoqëria e Jezusit, midis dokumenteve të Kongregatës së Përgjithshme XXXII, botoi Dekretin nr. 4 në të cilin deklaronte: “Misioni i Shoqërisë së Jezusit sot është shërbimi i fesë, për këtë arsye nxitja e drejtësisë është një absolut i nevojshëm”. Ky mision u ripohua nga Kongregatat e Përgjithshme të njëpasnjëshme XXXIII, XXXIV dhe XXXV.
- (199) Ky mision luajti një rol udhëheqës në mësimet e Eprorëve të Përgjithshëm Arrupe, Kolvenbach, Nicolás dhe Sosa. Misioni u shqyrtua në dokumente të hartuara nga assistancy-t dhe konferencat e Jezuitëve në mbarë botën, nga provincat dhe nga bashkësitë e institucionet jezuite.
- (200) Për më tepër, në *Contemplatio ad amorem*, zemra e Ushtrimeve Shpirtërore, Shën Injaci mëson se dashuria duhet të shprehet më shumë me vepra, sesa me fjalë.
- (201) Angazhimi për drejtësinë shoqërore nuk është dytësor në krahasim me misionin; është në qendër të tij.⁴⁸
- (202) Në nxitjen e tij apostolike *Evangelii gaudium*, Françesku ka theksuar se puna për drejtësinë është një kusht i domosdoshëm për një bashkësi të angazhuar në fenë autentike:
- (203) **“Një fe autentike - e cila nuk është kurrë komode dhe individualiste - sjell gjithmonë një dëshirë të thellë për ta ndryshuar botën, për të përçuar vlera, për të lënë diçka më të mirë pas kalimit tonë në tokë. Ta duam këtë planet të mrekullueshëm ku Hyji na ka vënë dhe ta duam njerëzimin që banon në të, me të gjitha tragjeditë dhe lodhjen e tij, me dëshirat dhe shpresat e tij, me vlerat dhe brishtësitë e tij. Toka është shtëpia jonë e përbashkët dhe të gjithë jemi vëllezër. Edhe pse «rendi i drejtë i shoqërisë dhe i shtetit është detyrë kryesore e politikës», Kisha «nuk mund dhe nuk duhet të qëndrojë jashtë luftës për drejtësi»”.**⁴⁹

48. <https://jesuits.global/it/uap/camminare-con-gli-esclusi>

49. http://www.vatican.va/content/francesco/it/apost_exhortations/documents/papa-francesco_esortazione-ap_20131124_evangelii-gaudium.html

- (204) Termi “burra dhe gra me dhe për të tjerët” vë në dukje që edukimi i Jezuitëve duhet t’u ofrojë nxënësve mundësinë që:
- (205) a. të formojnë zemra të hapura ndaj vuajtjes së të tjerëve nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë;
- (206) b. të zhvillojnë një ndërgjegje kritike për të kuptuar shkaqet kryesore të pabarazisë dhe të shtypjes;
- (207) c. të fitojnë kompetenca për të sjellë një ndryshim pozitiv në kulturën lokale dhe në botë;
- (208) d. të marrin guxim për të qenë të vendosur përballë moskuptimeve dhe kritikave.
- (209) **Shkollat tona duhet:**
- (210) Të respektojnë angazhimin katolik për paga të drejta, dinjitet të punës për sa u përket pagave, ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe të raportit mjekësor për kujdesje për fëmijën e sëmurë, si dhe uljes së tarifave të shkollës për merita dhe të ardhura.
- (211) T’i inkurajojnë ish-nxënësit që t’u bashkëngjiten kërkesave të drejtësisë sociale:
- I. angazhimi në praktika të drejta të punës;
- II. duke zgjedhur opsionin preferencial për të varfrit në aktivitetet e tyre tregtare dhe qytetare.
- (212) Të krijojnë partneritete që synojnë zvogëlimin e hendekut midis rrjeteve tona edukative “për të varfrit” dhe atyre “për klasat e mesme dhe të larta”, të cilat janë rritur veçmas, duke riprodhuar kështu ndarjen e shoqërive tona.
- (213) Në këtë kuptim, duhet ta pranojmë ftesën dhe sfidën e Atë Kolvenbach-ut: “Duhet t’u kërkojmë të gjithë nxënësve tanë që ta përdorin opsionin për të varfrit si kriter, në mënyrë që kurrë të mos marrin një vendim të rëndësishëm pa menduar më parë se si mund të ndikojë ai tek ata që zënë vendin më të ulët në shoqëri”.

Ushtrimi 23. Për shohitjen:

- b. Si e vlerëson këtë sfidë?
- c. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- d. Si mund të përshtatemi për t’iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- e. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- f. Çfarë duhet të bëjë më shumë?



- (214) Në një dokument të vitit 1980 me titull “Kolegjet tona: sot e nesër”, Eprori i atëhershëm i Përgjithshëm Atë Pedro Arrupe shkruan:
- (215) **“Edukimi ynë duhet t’u drejtohet të gjithëve, pa dallim. Nuk mund të jetë ndryshe, duke qenë se apostullimi i edukimit, si çdo apostullim i Shoqërisë, mban gjurmën e pashlyeshme injaciane të universalitetit. [...] Meqenëse kolegjet e Shoqërisë janë domosdoshmërisht instrumente të apostullimit - dhe për këtë arsye i nënshtrohen falasshmërisë rrënjësore të mbarështimeve tona dhe të varfërisë sonë - pranimi i nxënësve nuk mund të kushtëzohet nga mundësitë e tyre ekonomike. Kjo është një deklaratë themelore dhe një ideal”.**⁵⁰
- (216) Ideali për t’u arritur prej personave të të gjitha klasave shoqërore është më i vështirë për t’u arritur, sepse kostot e shkollimit janë rritur që nga viti 1980 e deri më sot, me rënien e personelit rregulltar dhe nevojën vendimtare për t’u siguruar kolegëve laikë një pagë të drejtë. Përveç kësaj, ka pasur një kërkesë të madhe për struktura me një cilësi të lartë, gjë që ka sjellë kosto shtesë, përveç nevojës për të investuar në teknologji.
- (217) Disa nga shkollat tona mbështeten shumë te tarifat e larta shkollave, të cilat mund të përjashtojnë personat e klasave të mesme dhe të ulëta.
- (218) Pa të ardhura që vijnë nga filantropia apo qeveritë, duket e pashmangshme të shkohet drejt një elitarizmi.
- (219) Është e rëndësishme që të njihen nisma të rëndësishme që synojnë ofrimin e mundësive edukative për të varfrit, si shkollat *Fe y Alegría*, shkollat *Nativity* dhe *Cristo Rey Schools*.
- (220) Megjithatë, shkollat më të pasura nuk mund të bëhen bashkësi të mbyllura, selektive, për elitën, duke i larguar njerëzit në vend që t’i afrojnë ata. Këto shkolla duhet të gjejnë mënyrën për të qenë të hapura për të gjithë, pavarësisht nga aftësia e tyre për të paguar shkollimin.

50. http://www.sjweb.info/documents/education/arr_colegios_it.pdf

- (221) Një shkollë e Jezuitëve nuk është e veçuar; ajo ofron shumë mundësi për të varfrit dhe një mjedis që sfidon mirëqenien përmes larmishmërisë socio-ekonomike të anëtarëve të bashkësisë të saj.
- (222) Një shkollë e Jezuitëve, në përgjigje të preferencës së dytë universale apostolike për të ecur me të varfrit dhe me të përjashtuarit, duhet t'i integrojë ata në botën e shkollës si shokë shkolle, qenie njerëzore me të njëjtin dinjitet. Bashkësitë vulnerabël dhe të përjashtuara duhet të bëhen shoqëruese të shkollave tona për të na ndihmuar në procesin e nxitjes së drejtësisë sociale dhe të ndryshimit të strukturave ekonomike, politike dhe sociale që krijojnë padrejtësi.⁵¹

Ushtrimi 24. Për shoshitjen:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- c. Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

51. <https://jesuits.global/it/uap/camminare-con-gli-esclusi>



- (223) Bota jonë sot vuan nga polarizimi dhe frika e të qenit ndryshe. Si pasojë kemi kalimin nga ndërsjellshmëria dhe komunikimi i ndershëm në egoizëm e intolerancë sipërfaqësore, të cilat marrin forma të ndryshme: nacionalizëm ekstrem, tribalizëm, racizëm, seksizëm dhe sektarizëm. Për më tepër, një kulturë globale konsumi e bazuar në treg i ka eklipsuar shpesh traditat dhe zakonet lokale. Këto dinamika ndodhin në shkallë ndërkombëtare, por gjenden edhe afër shtëpisë sonë. Ka qark shumë bashkësi të shkatërruara nga tensionet racore, etnike e fetare dhe nga dhuna e pakuptimtë që ato krijojnë.
- (224) Shkollat e Jezuitëve kanë një traditë të pasur shpirtërore për trajtimin e këtyre fenomeneve komplekse. Siç kujton *Kundrimi i Injacit mbi Mishërimin*, historia e shpëtimit zhvillohet në të gjitha vendet dhe është një dhuratë e Hyjit për të gjithë njerëzit. Pikërisht me këtë themel shpirtëror, misionarët Jezuitë përqaftuan procesin e inkulturimit: ta gjenin Hyjin, të pranishëm, në të gjitha vendet, ndërsa çonin mesazhin ungjillor të dashurisë së dhembshur hyjnore.
- (225) Edhe pse jo të gjithë paraardhësit tanë Jezuitë i kanë mishëruar vlerat e inkulturimit, kemi shembuj të mrekullueshëm të disave që e kanë bërë këtë gjë. Që nga fillimi i Shoqërisë, Jezuitët lanë rehatinë e Evropës për të gjetur mënyrën që t'i përfshinin njerëzit, të cilët jetonin në vende të largëta të globit. Për shembull, në polemikat mbi ritet kineze të shekujve XVII dhe XVIII, Jezuitët donin të bashkonin elemente të konfucianizmit me kultin katolik.
- (226) Po ashtu, Shoqëria e Jezusit në mbarë botën pranon se inkulturimi dhe dialogu ndërjetar janë përbërës thelbësorë të misionit të saj për të nxitur fenë dhe drejtësinë (GC 34).⁵²

52. http://www.vatican.va/archive/hist_councils/ii_vatican_council/documents/vat-ii_decl_19651028_nostra-aetate_it.html

- (227) Asnjë kulturë apo shoqëri nuk gjendet jashtë dashurisë shpëtuese të Hyjit dhe çdo person ka dinjitetin e birit dhe të bijës së Hyjit. Shkollat tona duhet të jenë vende ku inkurajohet dhe nxitet çdo përpjekje për solidaritet dhe bashkëpunim me të gjithë njerëzit vullnetmirë. “[Kisha] i nxit bijtë e vet me qëllim që, me kujdes dhe dashuri, nëpërmjet dialogut dhe bashkëpunimit me ndjekësit e feve të tjera, gjithmonë duke dëshmuar fenë dhe jetën e krishterë, të njohin, të zbatojnë dhe të zhvillojnë vlerat shpirtërore, morale dhe socio-kulturore që gjenden në të” (*Nostra Aetate*, nr. 2).
- (228) Në *fjalimin e tij të hyrjes* drejtuar delegatëve të edukimit në Rio de Zhaneiro në 2017, Atë Sosa ka përmbledhur se cila duhet të jetë qasja jonë edukative si Jezuitë në drejtim të përpjekjes për të pohuar atë që është universale në një botë multikulturore:
- (229) “Për të treguar konceptin e universalitetit prej të cilit frymëzohemi me proceset e globalizimit-mondializimit, mund të jetë e dobishme të kujtojmë përmbajtjen origjinale të konceptit të katolicitetit që i referohet universalitetit të Kishës, duke mirëpritur larmishmërinë e pamasë të situatave të tyre specifike.
- (230) Është po aq e dobishme të kujtojmë se Papa Françesku preferon të përdorë imazhin gjeometrik të “shumëfaqëshit” në vend të “sferës” kur flet për globalizimin.
- (231) Si koncepti i *katolicitetit*, ashtu edhe imazhi i *shumëfaqëshit* përfshijnë kuptimin e interkulturalitetit.
- (232) Ideali është që çdo qenie njerëzore, ose çdo popull, të jetë në gjendje të ndihet pjesë e njerëzimit duke u bërë i vetëdijshëm për kulturën e vet (“inkulturim”), pa e bërë atë absolute.
- (233) Duhet të veprohet në këtë mënyrë me një shpirt kritik, duke pranuar me gëzim ekzistencën e qenieve të tjera njerëzore që kanë kultura të ndryshme (“multikulturalitet”) dhe duke vendosur marrëdhënie me ta, duke u pasuruar me shumëllojshmërinë e kulturave, mes të cilave gjendet edhe kultura jonë (“ndërkulturaliteti”).

- (234) Universaliteti i jetuar në këtë mënyrë mund të bëhet një stimul për drejtësi shoqërore, vëllazëri dhe paqe.”⁵³
- (235) Sistemi edukativ i Jezuitëve duhet t’i përgjigjet pozitivisht dhe aktivisht pranisë së larmshmërisë mes nxënësve, mësuesve, prindërve, bashkësive dhe brenda rrjetit global të shkollave të tij.
- (236) Të gjithë jemi të thirrur të jemi nxënës dhe mësues në të njëjtën kohë, të angazhuar në veprimtarinë vendimtare të diskutimit qytetar për një kuptim gjithnjë e më të thellë të tij. Duke pranuar se të gjithë janë krijuar në përngjasim me Hyjin, edukimi i Jezuitëve duhet të përpiqet t’u ofrojë të gjithëve të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në zhvillimin e tyre tërësor. Larmishmëria dhe ndryshimi janë dhurata që duhen kremtuar për të krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse. Hyji është krijuesi i dashur i të gjitha gjërave dhe te Hyji gjejmë të përbashkëtën dhe solidaritetin tonë.

Ushtrimi 25. Për shoshitjen:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- c. Si mund të përshtatemi për t’iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

53. <https://www.educatemagis.org/keynotes/jesedu-rio2017-international-congress-keynotes/>

8.



Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në një rrjet global në shërbim të misionit

(237) Në një fjalim drejtuar edukatorëve të Filipineve në vitin 2009, Atë Nicolás-i u kujtoi të pranishmëve thirrjen për universalitet, që është në qendër të misionit të Jezuitëve. Ai tha:

(238) **“Nuk ka asgjë nga [kjo] ngushtësi në vizionin e Injazit për jetën. Ai ishte një njeri mendjegjerë: i pëlqente të shikonte yjet, pafundësinë e qiellit që pasqyronte dashurinë e Hyjit, e cila është universale dhe që përqafon gjithçka. Shqetësimi i Injazit ishte gjithmonë “e mira universale”, ai gjithmonë donte që Jezuitët të ishin gati të shërbenin kudo ku ka shpresë për lavdinë e Hyjit. Ai mblodhi rreth vetes një grup kaq të larmishëm njerëzish, gjuhësh, kulturash, kombësish dhe personalitetesh, për të formuar një grup të vetëm miqsh në Zotin, të cilët i kapërcenin dallimet e tyre të vogla, në përkushtimin e tyre të përbashkët për të njëjtin mision universal... sfidat e mëdha të botës nuk mund t’i përgjigjen një Province të vetme, një rajoni të vetëm apo vetëm Jezuitëve”.**⁵⁴

(239) Përparimet teknologjike kanë sjellë mundësi të reja të rëndësishme për ta bërë realitet këtë thirrje për universalitet.

(240) Sigurisht, në kontekstin lokal, shkollat e Jezuitëve duhet të rretizohen:

- I. me shkollat dhe agjencitë shtetërore, për të nxitur një arsim cilësor për të gjithë;
- II. me OJF-të e përkushtuara për të përmirësuar mundësitë edukative për të mirën e përbashkët;
- III. me ata që ofrojnë ndihmë sociale dhe shëndetësore në përgjigje të nevojave të ndryshme të nxënësve;
- IV. me famullitë dhe shtëpitë e Jezuitëve ku jepen Ushtrimet Shpirtërore për të ushqyer jetën shpirtërore të mësuesve dhe të anëtarëve të tjerë të bashkësisë shkollore;
- V. me famullitë dhe dioqezat lokale dhe me bashkësitë e tjera fetare.

(241) Por absolutisht, dhe me urgjencë të madhe, shkollat e Jezuitëve duhet të lidhen me njëra-tjetrën në të gjitha nivelet.

(242) Ndër shkollat tona, ato që mbeten të izoluara nga institucionet e tyre “motra” të pranishme kudo në botë, nuk do t’i njohin aspektet gjithnjë e më komplekse të një bote të globalizuar.

54. <https://www.educatemagis.org/documents/allocation-of-fr-general-on-the-occasion-of-the-150th-anniversary-of-jesuit-education-in-the-philippines/>

- (243) Secila nga shkollat tona duhet parë dhe duhet ta shohë veten si një zgjatim i misionit tonë universal.
- (244) Tradicionalisht, shkollat e Jezuitëve ndërvepronin me njëra-tjetrën përmes strukturave të qeverisjes së brendshme të Shoqërisë së Jezusit: rajone, provinca dhe assistancy-ve.
- (245) Ndërsa këto rrugë bashkëpunimi duhet të vazhdojnë, edukatorët jezuitë duhet gjithashtu të gjejnë mënyra të reja dhe novatore për të siguruar njësinë duke respektuar parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit vendimet më të mira merren prej vendit më të afërt me vendin ku veprohet dhe në dritën e atij konteksti të veçantë.
- (246) Platforma *educatmagis.org*, siç tregohet më sipër, ofron një forum për shpërndarjen e dokumenteve dhe për të stimuluar mësimnxënien dhe shkëmbimin e ndërsjellë rreth shkollave. Është thelbësore që edukatorët jezuitë në mbarë botën të bashkohen dhe ta përdorin këtë burim të rëndësishëm.
- (247) Edhe një herë, ia vlen të reflektohet mbi *Action Statement*-in JESEDU të Rios të 2017, ku delegatët rajonalë morën angazhimet e mëposhtme:⁵⁵
- (248) **Delegatët angazhohen, gjatë vizitave dhe supervizimeve të shkollave, të vlerësojnë dhe të zhvillojnë nivelin ekzistues të bashkëpunimit të rrjetit rajonal dhe global.**
- (249) **Delegatët angazhohen të përfshijnë në programet e formimit për mësuesit dhe stafin e ri një kuptim të faktit që mësues dhe staf i bashkohen një rrjeti global dhe kanë një rol për të luajtur në gjallërimin e tij.**
- (250) **Delegatët gjithashtu angazhohen të punojnë me leadership-in e shkollës për t'i detyruar të gjithë mësuesit dhe stafin që të formohen në qytetarinë globale, në mënyrë që t'i ndihmojnë nxënësit ta kuptojnë të ardhmen e tyre si qytetarë globalë.**
- (251) **Delegatët angazhohen që ta bëjnë Educate Magis-in një mjet dhe burim integral në shkolla, me qëllim gjallërimin e dimensionit të tyre global.**

Ushtrimi 26. Për shoshitjen:

- Si e vlerëson këtë sfidë?
- Cilat janë pengesat më domethënëse?
- Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- Çfarë duhet të bëjë më shumë?

55. <https://www.exleo.org/wp-content/uploads/2019/05/ExLeo-Congresso-delegati-Rio-2017.pdf>

9.

Shkollat e Jezuitëve janë të angazhuara në shkëlqyeshmërinë njerëzore



- (252) Shumë nga shkollat tona njihen me të drejtë për programet e tyre të shkëlqyera akademike. Disa janë të njohura për shkëlqyeshmërinë e tyre në përgatitjen e nxënësve për të qenë të aftë në teknologji, bujqësi dhe specialitete të tjera.
- (253) Duke reflektuar mbi ndryshimet e shpejta globale që po përjetojmë, shkëlqyeshmëria në cilëndo prej shkollave tona do të kërkojë një dialog të vazhdueshëm se si ne edukojmë: çfarë pedagogjish? Çfarë kurrikule?
- (254) Kjo sfidë u theksua nga Ati Gjeneral Arturo Sosa në JESSEDU Rio në vitin 2017:
- (255) **Është urgjente që institucionet tona të jenë hapësira për kërkime pedagogjike dhe laboratorë realë të novacionit didaktik, nga ku mund të dalin metoda apo modele të reja formimi.**
- (256) **Kjo do të na kërkojë të eksplorojmë atë që bëjnë të tjerët dhe çfarë mund të mësojmë prej tyre, si dhe të kuptojmë se çfarë propozon shkencë e pedagogjisë për një botë gjithnjë e më teknike dhe të karakterizuar nga kultura dixhitale në të cilën ata kanë lindur dhe janë rritur.**
- (257) **Është e nevojshme që institucionet tona të jenë të vetëdijshme për ndryshimin antropologjik dhe kulturor që po jetojmë dhe të jenë në gjendje të edukojnë dhe të formojnë në një mënyrë të re për një të ardhme tjetër.⁵⁶**
- (258) Të gjitha shkollat e Jezuitëve duhet të jenë të shkëlqyeshme në humanizimin e bashkësive të tyre, domethënë t'i ndihmojnë nxënësit dhe personelin jo-mësimdhënës që ta thellojnë empatinë e tyre dhe të krijojnë lidhje të qëndrueshme miqësie.
- (259) Shkollat tona duhet të mësojnë se cili është dinjiteti i gruas, si bashkëpunëtore e barabartë në çdo nismë.

56. <https://www.educatemagis.org/documents/allocution-fr-arturo-sosa-sj-jesedu-rio-congress-2017/>

- (260) Shkollat duhet të luftojnë në mënyrë aktive racizmin në të gjitha format e tij.
- (261) Shkollat duhet të mësojnë dhe të krijojnë një atmosferë në të cilën të gjithë bijtë e Hyjit, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, janë të mirëpritur.
- (262) Duke pasur si bazë parimin e cura personalis-it - kujdesit për personin - shkolla duhet ta vlerësojë dinjitetin dhe vlerën e secilit prej anëtarëve të saj.
- (263) Shumë edukatorë jezuitë e kanë parë të rëndësishme të reflektojnë mbi letrën që Atë Kolvenbach-u shkroi si një hyrje në vëllimin *Pedagogjia Ignacijane*:
- (264) | **“Lutem që një hap tjetër i rëndësishëm të bëhet drejt arritjes së qëllimit tonë si edukatorë që të formojmë burra dhe gra të vetëdijshëm, kompetentë, të dhembshur dhe të angazhuar”.**⁵⁷
- (265) Më pas, dokumenti *Jesuit Education Aims at Human Excellence* (2015) e ndau më tej atë qëllim, duke deklaruar:
- (266) | **“Këto katër terma shprehin përsosmërinë njerëzore që Shoqëria e Jezuitit dëshiron për të rinjtë që shoqëria na ka besuar”.**⁵⁸
- (267) Edukimi i Jezuitëve duhet të synojë formimin e grave dhe të burrave me ndërgjegje, dhembshuri, përkushtim dhe kompetencë.
- (268) *Ndërgjegje*, sepse përveç njohjes së vetvetes, falë zhvillimit të aftësisë së tyre për të brendësuar dhe për të kultivuar një jetë shpirtërore, kanë një njohuri dhe përvojë koherente të shoqërisë dhe të çekuilibrave të saj.
- (269) *Dhembshuri*, sepse janë në gjendje t'i hapin zemrat e tyre për të qenë solidarë dhe për të marrë përsipër vuajtjen e të tjerëve.
- (270) *Përkushtim*, sepse, duke qenë të dhembshur, angazhohen ndershmërisht në fe dhe, me mjete paqësore, punojnë për shndërrimin shoqëror dhe politik të vendeve dhe të strukturave të tyre sociale për të arritur drejtësinë.

57. <https://www.educatemagis.org/documents/ignatian-pedagogy-letter-from-father-general-kolvenbach-sj/>

58. <https://www.educatemagis.org/jesedurio2017/human-excellence/>

(271) *Kompetencë*, sepse duhet të jenë:

- a. të aftë për t'i krijuar, për t'i kuptuar dhe për t'i përdorur njohuritë dhe aftësitë që të jetojnë në kontekstin e tyre dhe ta shndërrojnë atë;
- b. në gjendje që të jetë pjesë e një bote të ndryshueshme dhe të larmishme, duke krijuar një projekt jete për të tjerët dhe me të tjerët;
- c. në gjendje që t'i zhvillojnë aftësitë intelektuale, akademike, emocionale dhe sociale të nevojshme për realizimin profesional dhe njerëzor.

(272) Nuk duhet ta anashkalojmë emfazën tonë tradicionale mbi shkëlqyeshmërinë akademike. Ajo u mundëson shkollave tona që të luajnë njërin prej roleve themelore shoqërore të shkollës dhe u mundëson atyre të dialogojnë me shoqërinë më të gjerë mbi domethënien e një shkollimi cilësor. Megjithatë, në shkollat tona ky angazhim duhet të futet në një kontekst shkëlqyeshmërie njerëzore.

Ushtrimi 27. Për shoshitjen:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- c. Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?






- (273) Le të kthehemi edhe një herë në qendrën e përshtirësive injaciane. Burimi ynë kryesor i shpresës dhe i gjallërimit qëndron në gjetjen e Hyjit në të gjitha gjërat. Çfarë do të thotë kjo?
- (274) Do të thotë ta përjetosh atë bërthamë të gjerë që shkakton mrekullim, shpresë, gëzim, hare, dhembshuri, lidhje, kudo, me gjithçka, në gjithçka. Aty gjejmë Hyjin. Shumë njerëz e kanë përjetuar këtë mrekulli kur ishin shumë të vegjël, si një zgjim të parë ndaj krijimit.
- (275) Detyra jonë, si edukatorë, është ta rifreskojmë dhe ta thellojmë përshtirërinë tonë, në mënyrë që të jemi në gjendje, siç thoshte Jezusi, të hyjmë në mbretëri “si fëmijë”. Është thelbësore që të angazhohemi në praktika shpirtërore që forcojnë bindjen se kjo përvojë zgjeruese, kjo bërthamë mrekullie, është një mënyrë për ta gjetur Hyjin. Kjo mund të ketë një efekt të dukshëm në mësimdhënie. Mund t’i inkurajojë nxënësit dhe ish-nxënësit tanë, që na marrin si model, të angazhohen intensivisht në botë, të mos e humbasin kurrë kureshtjen, krijimtarinë, gëzimin e kërkimit, besimin, lidhjen dhe dhembshurinë e tyre për gjithçka që ekziston.
- (276) E njohim citimin e famshëm që i atribuohet Atë Pedro Arrupe-s, i cili shpreh se çfarë do të thotë “të gesh Hyjin”:
- (277) **Asgjë nuk është më praktike se sa të gesh Hyjin. Do të thotë të biesh në dashuri në mënyrë absolute, kategorike.**
- (278) **Ajo me të cilën je i dashuruar, ajo që kap imagjinatën tënde, do të ndikojë në gjithçka.**
- (279) **Ajo do të vendosë se çfarë do të të ngrejë në mëngjes nga shtrati, çfarë do të bësh gjatë mbrëmjeve të tua, si do t’i kalosh fundjavat, çfarë do të lexosh, kë do të njohësh, çfarë do të të thyejë zemrën dhe çfarë do të të mahnisë prej gëzimit dhe mirënjohjes.**
- (280) **Dashurohu, vazhdo e dashuro, dhe kjo gjë do të përcaktojë çdo gjë.**
- (281) Shkollat tona duhet të ofrojnë mundësi, brenda dhe jashtë klasës, që nxënësit tanë ta përjetojnë botën në këtë mënyrë: të dashurohen me të.
- (282) Shkollat tona duhet të ofrojnë mundësi për zhvillimin e një përshtirërie reflektuese që kërkon vazhdimisht Hyjin. Një përshtirëri që rritet fuqishëm pak nga pak që nxënësit tanë rriten: bëhet më komplekse ndërsa ata bëhen më kompleksë. Kjo pjekuri shpirtërore mund t’i shoqërojë ata gjatë gjithë jetës.

- (283) Që nga fillimi i tyre, një detyrë e shkollave të Jezuitëve ka qenë që t'i udhëheqë nxënësit drejt kësaj përsëritërie gjithnjë e më të thellë si në shkollë, ashtu edhe në jetën e tyre të përditshme, duke përdorur procesin e shoshitjes. Të mësosh të dëgjosh dhe të pranosh dhuntitë e talentet unike me të cilat njeriu është i talentuar, pyetjet dhe ankthet, gëzimet e mëdha dhe dëshirat e thella, është dhurata e fundit e një edukimi të rrënjosur në një vizion "të mishëruar". Si do ta kaloj jetën time? Kujt i përkas? Për çfarë po më thërret Hyji?
- (284) Duke soditur vështrimin e Trinisë së Shenjtë mbi botën tonë, maturantët tanë do ta pyesin veten: "Si mund t'i përdor dhuratat dhe talentet e mia që kam marrë nga Hyji për t'iu përgjigjur nevojave të njerëzve të familjes sime, të qytetit tim, të rajonit tim të botës dhe të bashkësisë globale?" Këto kanë qenë gjithmonë pyetjet e thella që ishin në bazë të pyetjeve që bëheshin në klasat e Jezuitëve.
- (285) Prandaj, suksesi përfundimtar i angazhimit tonë edukativ nuk mund të matet me atë se si është personi i pjekur në maturë. Përkundrazi, dhurata e shkollës së Jezuitëve vlerësohet më mirë duke parë se si të diplomuarit do ta kenë angazhuar jetën e tyre në dekadat në vijim: a vazhdonin t'i bënin dhe t'i ribënin gjatë gjithë jetës së tyre pyetjet që ua bënin në klasë? Mundësitë që u janë dhënë atyre nga lidhja në rrjet mes shkollave tona dhe nga mundësia e një takimi autentik a i kanë dhënë frytet e veta në vendimet e ardhshme në biznes, në jetën personale dhe në kërkimin e fesë?
- (286) A ka sjellë ndonjë ndryshim takimi me Krishtin nëpërmjet Shpirtit Shenjt në mënyrën në të cilën nxënësi, në fund të shkollës, bëri shoshitjen e tij mbi karrierën, mënyrën e jetesës, vlerat, kriteret për sukses apo dështim? Vlerësimi se si shkollat tona i përgatisin nxënësit për ta bërë këtë detyrë është metri me të cilin ne i konsiderojmë ata të denjë për të mbajtur emrin: "nxënës të Jezuitëve".

Ushtrimi 28. Për shoshitjen:

- a. Si e vlerëson këtë sfidë?
- b. Cilat janë pengesat më domethënëse?
- c. Si mund të përshtatemi për t'iu përgjigjur kësaj sfide për të gjitha shkollat tona në mënyrë që të synohet e mira më e madhe?
- d. Në këtë lëmë, çfarë ka bërë apostullimi yt edukativ?
- e. Çfarë duhet të bëjë më shumë?

Pärmbyllje



- (287) Me këtë dokument kemi nisur së bashku një udhëtim reflektimi. Kemi njohur në mënyrën më të mirë të mundshme disa shenja të kohës që ndikojnë dhe sfidojnë kontekstet tona specifike edukative. Në përputhje me traditën injaciane për ta kërkuar dhe për ta gjetur gjithmonë Hyjin në të gjitha gjërat, tani sfidohemi që të mos kënaqemi me “notën e vetme”, e cila në të njëjtën kohë mund të na japë një tingull të mrekullueshëm, por nuk krijon muzikë; përkundrazi, jemi të sfiduar të mbajmë gjallë procesin reflektiv në mënyrë që të vazhdojmë të bëjmë “muzikë të re” dhe të gjejmë nota të tjera në harmoni me kontekstet, përvojat dhe kohët tona në zhvillim të vazhdueshëm.
- (288) “Elementet identifikuese globale” të shkollave të Jezuitëve duhet të na ftojnë të reflektojmë në thellësi mbi identitetin dhe kontributin tonë specifik në botën e edukimit. Shkollat tona janë të lidhura qartë dhe fort me vizionin dhe përshtirësinë e Shën Injacit; prandaj, thirrja jonë është për një ushtrim të vazhdueshëm shoshitës për ta kuptuar këtë identitet jo si një entitet të ngurtë, por gjithmonë si një thirrje për një “besnikëri krijuese” ndaj themeluesve tanë.
- (289) Prandaj, sugjerimi ynë modest është që ky dokument të bëhet një instrument për t’u përdorur, jo një herë ose dy herë, por pa pushim në shkollat tona në mënyrë që të njëjtat pyetje, bërë në ditë dhe kohë të ndryshme, të japin përgjigje gjithnjë e më të mira, të tilla që t’i bëjnë shkollat tona gjithnjë e më të përshtatshme për botën në të cilën ndodhen. Në këtë kuptim, shkollat e lënë veten të formohen nga nevojat e botës, ndërsa në të njëjtën kohë përpiqen ta formojnë atë botë në mënyrë që të zbulojnë më mirë praninë dhe veprën e Hyjit në mesin tonë.
- (290) Ashtu si Ushtrimet Shpirtërore, ky dokument nuk është menduar thjesht dhe vetëm për t’u lexuar. Përkundrazi, shpresojmë se do të bëhet një “tekst i gjallë”, që mund edhe të ndryshojë me kalimin e kohës përmes feedback-eve dhe shoshitjeve që ai nxit. Në këtë kuptim, ky tekst duhet të çojë në reflektime dinamike dhe të thella brenda shkollave tona dhe në institucione të tjera që janë pjesë e rrjeteve tona edukative; reflektime që pak nga pak do të përfshihen në tekst.

5 nëntor 2019, me rastin e festës së të Gjithë Shenjtërve dhe të të Lumëve të Shoqërisë së Jezusit

Shtojcë: një përshkrim skematik*

* Dokument origjinal marrë nga “Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit” (1986), Shtojca II: Një përshkrim skematik. Teksti është modifikuar pjesërisht nga Atë José Mesa S.J. që të kuptohet me më lehtësi.

(Kjo tabelë përmbledh marrëdhënien midis vizionit shpirtëror të Injazit dhe karakteristikave të edukimit të Jezuitëve. Nëntë pikat në shtyllën e parë përsërisin titujt injacianë për nëntë seksionet e para të pjesës kryesore të tekstit; shënimet në fund të faqes e lidhin këtë material me shkrimet e Injazit - kryesisht me Ushtrimet Shpirtërore dhe me Kushtetutat - dhe me paragrafët e përmbledhjes historike që ndodhet në Shtojcën I. Njëzet e tetë karakteristikat themelore të edukimit të Jezuitëve përsëriten në shtyllën e dytë, të paraqitura në mënyrë që të tregojnë themelin e tyre në vizionin e Injazit për botën. Kjo nuk ka për qëllim të tregojë një paralelizëm “të saktë”, por një zbatim të drejtpërdrejtë, prandaj do të ishte më e saktë të thuhej se karakteristikat rrjedhin ose i kanë rrënjët në vizionin injacian).

Vizioni i Injazit për botën	Karakteristikat e edukimit të Jezuitëve
<p>1. Hyji Për Injacin, Hyji është Krijuesi dhe Zoti, Mirësia më e Madhe, realiteti i vetëm absolut;⁵⁹ çdo realitet tjetër vjen nga Hyji dhe ka vlerë vetëm në atë masë që na çon tek Ai⁶⁰: Hyji është i pranishëm në jetën tonë “duke punuar fort për ne” në çdo gjë;</p> <p>Ai mund të njihet nëpërmjet fesë në çdo ngjarje natyrore dhe njerëzore, në tërësinë e historisë dhe më veçanërisht në jetën e çdo njeriu.⁶¹</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pohon pozitivitetin rrënjësor të botës. 2. Nxit formimin tërësor të çdo personi brenda bashkësisë njerëzore. 3. Përfshin një dimension fetar që përshkon krejt edukimin. 4. Është një instrument apostolik. 5. Nxit dialogun mes fesë dhe kulturës.
<p>2. Liria njerëzore Çdo njeri është personalisht i njohur dhe i dashur nga Hyji. Kjo dashuri na fton që të japim një përgjigje; por për të qenë autentikisht njerëzore, një përgjigje duhet të lindë nga liria rrënjësore.⁶² Prandaj, për t’iu përgjigjur dashurisë së Hyjit, çdo person është thirrur që të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - i lirë për ta dhuruar vetveten dhe për të pranuar përgjegjësinë për veprimet e veta dhe pasojat e tyre: i lirë për të qenë besnik; - i lirë për të punuar me fe ndaj asaj lumturie të vërtetë që është qëllimi i jetës: i lirë të angazhohet me të tjerët në shërbim të Mbretërisë së Hyjit për shpëtimin e krijimit.⁶³ 	<ol style="list-style-type: none"> 6. E vë theksin në kujdesin specifik të personit. 7. Thekson rolin aktiv të nxënësit. 8. Zhvillon dëshirën për ta vazhduar mësimnxënien gjatë gjithë jetës.

Vizioni i Injazit për botën	Karakteristikat e edukimit të Jezuitëve
<p>3. Kërkimi i lirisë Për shkak të mëkatit dhe të efekteve të tij, liria për t'iu përgjigjur dashurisë së Hyjit nuk është automatike. Me ndihmën dhe forcën që vijnë nga dashuria shëlbuese e Hyjit, jemi të angazhuar në një luftë të vazhdueshme për t'i njohur dhe për t'i hequr pengesat që bllokojnë lirinë e vërtetë - përfshirë edhe efektet e mëkatit - dhe për t'i zhvilluar aftësitë e nevojshme për ushtrimin e lirisë së vërtetë.⁶⁴</p> <p>a. Kjo liri kërkon një njohje të vërtetë, dashuri dhe pranim të vetvetes të shoqëruar me vendosmërinë për t'u liruar nga çdo lidhje e tepruar me mirëqenien, vlerësimin, shëndetin, pushtetin apo çdo gjë tjetër, madje edhe vetë jetën.⁶⁵</p> <p>b. Liria e vërtetë kërkon edhe një njohje realiste të forcave të ndryshme të pranishme në botën që na rrethon; ajo përfshin lirinë nga perceptime të shtrembëruara të realitetit, vlerat e falsifikuara, qëndrimet dhe pozicionet e ngurta që varen nga ideologji të ngushta dhe të pamjaftueshme.⁶⁶</p> <p>c. Për ta arritur këtë liri të vërtetë, duhet të mësojmë t'i njohim dhe t'i vlerësojmë ndikimet që mund ta nxisin ose kufizojnë atë: lëvizjet e zemrës sonë, përvojat e kaluara të të gjitha llojeve, ndërveprimet me të tjerët, dinamizmat e historisë, të strukturave shoqërore dhe të kulturës.⁶⁷</p>	<p>9. Është një edukim vlerash.</p> <p>10. Inkurajon njohjen realiste, dashurinë dhe pranimin e vetvetes.</p> <p>11. Ofron gjithashtu një njohje realiste të botës në të cilën jetojmë.</p>

Vizioni i Injazit për botën	Karakteristikat e edukimit të Jezuitëve
<p>4. Krishti model i njerëzimit Vizioni i Injazit për botën përqendrohet në personin historik të Jezu Krishtit.⁶⁸ Me përgjigjen totale që Ai i jep dashurisë së Atit, duke e vënë veten në shërbim të të tjerëve, bëhet model për jetën e njerëzve.</p> <p>Ai bashkëndan gjendjen tonë njerëzore dhe na fton që ta ndjekim nën flamurin e kryqit në një përgjigje dashurie ndaj Atit.⁶⁹</p> <p>Ai është i gjallë në mesin tonë dhe mbetet përgjithmonë Njeriu për të tjerët në shërbim të Hyjit.</p>	<p>12. E paraqet Krishtin si model për jetën e njerëzve.</p> <p>13. Realizon një përkujdesje të përshtatshme baritore.</p> <p>14. E kremton fenë në lutjen personale dhe bashkësiore, në adhurim dhe shërbim.</p>
<p>5. Veprimi Një përgjigje ndaj dashurisë së Hyjit e lirë dhe e nxitur nga dashuria nuk mund të jetë thjesht spekulative apo teorike. Me çdo kusht, parimet spekulative duhet të çojnë në veprime vendimtare: “dashuria shfaqet në vepra”.⁷⁰</p> <p>Injaci u kërkon burrave dhe grave një angazhim total dhe aktiv. Për ta imituar Krishtin dhe për të qenë efektivisht si Ai, njeriut i duhet të vërë në praktikë idealet e veta</p> <p>Në realitetin e familjes, të biznesit, të lëvizjeve shoqërore, të strukturave ligjore dhe të aktiviteteve fetare, të politikës.⁷¹</p>	<p>15. Të përgatit për një angazhim aktiv jete.</p> <p>16. Është në shërbim të një feje, që nxit drejtësinë.</p> <p>17. Përpiqet të formojë burra dhe gra për të tjerët.</p> <p>18. U kushton një vëmendje të veçantë të varfërve.</p>

<p>Vizioni i Injazit për botën</p>	<p>Karakteristikat e edukimit të Jezuitëve</p>
<p>6. Në Kishë Për Injacin, përgjigja ndaj thirrjes së Krishtit mund të bëhet veç brenda dhe nëpërmjet Kishës katolike, instrumenti nëpërmjet të cilit Krishti është i pranishëm në mënyrë sakramentale në botë.⁷² Maria, Nëna e Jezusit, është modeli i kësaj përgjigjeje.⁷³</p> <p>Injaci dhe shokët e tij të parë ishin të gjithë priftërinj dhe donin ta vinin Shoqërinë e Jezusit në shërbim të Vikarit të Krishtit, “për t’u dërguar në çdo vend ku ai mendonte se ishte e përshtatshme t’i dërgonte për lavdinë e Hyjit dhe për një të mirë gjithnjë e më të madhe të shpirtave”.⁷⁴</p>	<p>19. Është një instrument apostolik në shërbim të Kishës, që e zhvillon misionin e saj në shërbim të njerëzve.</p> <p>20. I përgatit nxënësit të marrin pjesë aktivisht në jetën e Kishës dhe të bashkësisë lokale, në shërbim të të afërmit.</p>
<p>7. Magis-i Injaci ka këmbëngulur vazhdimisht për “magis”-in - “më shumë”. Tensioni i tij i vazhdueshëm ishte për një shërbim ndaj Hyjit me vlerën më të madhe, të realizuar në një ndjekje gjithnjë e më besnike të Krishtit.⁷⁵ I njëjti shqetësim gjallëroi veprën apostolike të shokëve të tij të parë.</p> <p>Përgjigja konkrete ndaj dashurisë së Hyjit duhet të ketë “vlerën më të madhe”.</p>	<p>21. Kërkim i shkëlqyeshmërisë në punën e formimit.</p> <p>22. Jep dëshmi shkëlqyeshmërie.</p> <p>23. Thekson bashkëpunimin.</p>

Vizioni i Injazit për botën	Karakteristikat e edukimit të Jezuitëve
<p>8. Bashkësia Kur Injaci përjetoi dashurinë e Hyjit, të zbuluar në Krishtin, dhe filloi t'i përgjigjej asaj me dhurimin e vetvetes për t'i shërbyer Mbretërisë së Hyjit, ai deshi ta bashkëndante përvojën e vet me disa shokë që u bënë "miq në Zotin", për t'u shërbyer të tjerëve.⁷⁶</p> <p>Fuqia e një bashkësie që punon në shërbim të Mbretërisë është më e madhe, sesa ajo e një individi ose grupi të vetëm individësh.</p>	<p>24. Bazohet mbi një frymë bashkësie që njëson: mësuesit dhe drejtuesit, bashkësia e Jezuitëve, këshillët drejtues, prindërit, nxënësit, ish-nxënësit, bamirësit.</p> <p>25. Është strukturuar në mënyrë që të nxisë shpirtin e bashkësisë.</p>
<p>9. Shoshitja Injaci dhe shokët e tij i merrnin vendimet e tyre përmes një procesi të vazhdueshëm shoshitjeje individuale dhe bashkësiore, që e bënin gjithmonë në një kontekst lutjeje. Një reflektim i ngjashëm, në lutje, mbi rezultatet e veprimtarisë së tyre i shtyu shokët t'i rishikonin vendimet e mëparshme dhe t'i përshtatnin metodat që përdornin, në kërkimin e vazhdueshëm të një shërbimi të Hyjit "me vlerën më të madhe" (magis).⁷⁷</p>	<p>26. Përshtat mjetet dhe metodat për t'i arritur më mirë qëllimet e veta.</p> <p>27. Përbën një sistem shkollash të karakterizuara nga një vizion dhe objektiva të përbashkëta.</p> <p>28. Ndihmon për të siguruar, veçanërisht mësuesve, një mundësi formimi të vazhdueshëm dhe përsosjeje të kompetencave profesionale.</p>

59. Shtojcë I (183/); emrat që Injaci përdor për "Hyjin" gjenden te shkrimet e tij. Shih, p.sh., U.SH. [15-16].
60. Ky është *Parimi dhe Themeli i Ushtrimeve Shpirtërore* [23]; shih shënimin 8, sipër.
61. Hyji që punon për ne nëpërmjet Krijimit është një tezë themelore e Përsheptërisë Injacione. Dy shembuj marrë nga *Ushtrimet Shpirtërore* janë "kundrimi i Mishërimit" [101-109] dhe "kundrim për të arritur dashuri" [230-237]. Citimi është marrë nga numri [236]. Injaci fliste vazhdimisht "për të parë se si Zoti banon te krijesat"; kjo ide u perifrashua nga Nadal-i (njëri prej shokëve të parë të Injacionit) në shprehjen e famshme "soditës në veprim".
62. Shtojca I (1841)
63. Shprehja "liri shpirtërore" përmbledh qëllimin që personi dëshiron të arrijë duke bërë Ushtrimet Shpirtërore. Vetë Injaci e titullon libërthrin e tij "Ushtrime Shpirtërore", duke treguar se qëllimi i këtyre ushtrimeve është "për ta mundur vetveten dhe për ta orientuar jetën pa u kushtëzuar nga ndonjë ndjenjë sado e çrregullt qoftë". [21]
64. Shtojca I (183/); ky pohim është përmbledhja e "javës së parë" të Ushtrimeve.
65. Shtojca I (184/); U.SH. [1], [313-329] ("Rregulla për Shoshitjen e Shpirtave")
66. Shtojca I (184/); U.SH. [142-146] ("Dy Flamujtë").
67. U.SH. [24-42] ("Shqyrtimi i Ndërgjegjes"), si edhe "Dy Flamujtë" cit.
68. Shtojca I (184/), (193/); U.SH. [53], [95-98] ("Mbretëria e Krishtit"), [167] ("Shqyrtimi mbi tre mënyrat e Përvujtërisë"). "Java" e dytë, e tretë dhe e katërt e Ushtrimeve janë të orientuara për ta shtyrë atë që i merr këto ushtrime që të angazhohet me jetën e vet për ta ndjekur Krishtin.
69. U.SH: [116] ("Kundrimi mbi Lindjes"); shih edhe "Dy Flamujtë", cit.
70. Shtojca I (184/), (190/); U.SH. [135], [169-189] ("Zgjedhja").
71. Shtojca I (188/), (184/).
72. U.SH. [352-370] ("Rregulla për të ndier bashkë me Kishën"); Formula e Kushtetutave [66-68], [3], [603], e vijim në shkrimet e Injacionit. Kur Injaci kuptoi se nuk mund t'i shërbente drejtpërdrejt Krishtit në Tokën e Shenjtë, vendosi që të bënte "gjënë më të mirë të afërt" duke shkuar në Romë për t'i shërbyer Kishës nën "Vikarin e Krishtit".
73. Devocioni i Injacionit ndaj Marisë, Nënës së Jezusit, është diçka që vihet re përgjatë gjithë jetës së tij, siç është vënë në dukje te Shtojca I (171). Shtegtimi i Injacionit nga ana tjetër filloi në Monserrat; Maria iu shfaq disa herë gjatë Ushtrimeve. P.sh. [47], [63], [102], [111], [147], [218], [299].
74. Shtojca I (191/), (793/). Sipas disa autorëve, Injaci është shpikësi i termit "Vikar i Krishtit". Nëse është apo jo e vërtetë, besnikëria ndaj Papës është një karakteristikë si e Injacionit, ashtu edhe e Shoqërisë së Jezusit të themeluar prej tij.
75. Shtojca I (184/); U.SH: [97], [155].
76. Shtojca I/ (1891), (1921).
77. "Shoshitja e shpirtave" është një pikë transversale në krejt jetën e Injacionit; është e dukshme në Manrezë (Shtojca I, 181 /), dhe më pas rritet vazhdimisht. Ekziston një dokument i shkurtër, i titulluar "Fjalimi i Etërve të Parë", i cili përshkruan shoshitjen që e çoi Injacionin dhe shokët e tij të parë në themelimin e Shoqërisë së Jezusit. Krh. edhe Shtojcën I (189) - (193), mbi procesin që çoi në *Ratio Studiorum*-in e parë, dhe U.SH. [313-336] ("Rregullat për Shoshitjen e Shpirtave").









